



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në  
“Violinë dhe Mësuesi”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve Tiranë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.dr. Gezim Dibra

2. Prof.ass. Besa Lusha

Prill 2023

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

**Pergjigje e GVJ ne lidhje me komentet e bera nga GVB te UART mbi Draft RVJ e Programit te studimit Master i Arteve ne "Violine dhe Mesuesi"**

**Lidhur me fushen II Standarti II.1 Konkluzione**, ne raport shkruhet : "Rezulton se 3 nga 5 lëndët e modulit A Lëndë bazë përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme nuk janë të plotësuar sipas formatit që është dhe nuk janë të kodifikuara."

Pergjigja e GRB te UART është : " GVB duke vlerësuar gjetjen e GVJ, sqaron se lëndet e modulit A që i perkasin mësuesisë janë të njëjta në të gjitha programet e studimit të UART si në drejtim të përmbajtjes se lëndes ashtu edhe në sasinë e oreve dhe krediteve dhe realizohen nga i njëjti staf akademik për të 32 programet e UART. Cdo pasaktësi mund të jetë një gabim në zgjedhjen e evidencës, për të cilën kërkojmë mirëkuptimin tuaj"

Pergjigja nga GVJ : GVJ i programit të studimit Master i Arteve në Violine dhe Mesuesi në konkluzionin lidhur me Syllabuset është bazuar në evidencat e paraqitura nga grupi i punës dhe nuk ka ndonjë evidence tjetër të paraqitur bashkë me pergjigjet e tyre. Pergjigja e grupit të punës nuk është shoqëruar me evidence të re, ndaj në nuk mund të bëjmë ndryshim në raportin tonë.

**Lidhur me fushen II Standarti II.3 Konkluzione**, ne raport shkruhet: "Konstatohet se një dy apo tre programe lëndore janë jo të perditsuar, apo nuk janë sipas formatit të miratuar nga vete departamenti sipas udhëzimeve të marra, apo nuk kanë të gjithë elementët e kërkuar. Programet e lëndëve paraqitura ka që janë edhe 2019-2020 dhe , nuk ka asnjë program 2021-2022.

Pergjigja e GRB te UART është : GVB duke vlerësuar gjetjen dhe rekomandimin e GVJ, sqaron se: programet e lëndëve janë të pa ndryshuara që nga riorganizimi i programit të studimit. Dorezimi i evidencave pa vitin akademik të perditesuar është një lapsus nga ana jonë. Kërkojmë ndjesë."

Pergjigja nga GVJ : GVJ i programit të studimit Master i Arteve në Violine dhe Mesuesi në konkluzionin lidhur me Syllabuset është bazuar në evidencat e paraqitura nga grupi i punës dhe nuk ka ndonjë evidence tjetër të paraqitur bashkë me pergjigjet e tyre. GVJ mendon se konkluzioni nuk lidhet shumë me përmbajtjen e formatin se sa me procedurat e miratimit cdo vit në departament të syllabuseve të programit pavarësisht ka apo nuk ka ndryshime. Ndaj GVJ mendon se nuk mund të bëjë ndryshime në raport.

**Lidhur me fushen III Standarti III.3 Konkluzione**, ne raport shkruhet: GVJ mendon se institucioni përdor formën dhe procedurën të vlefshme vlerësimi duke garantuar një vlerësim objektiv dhe në kohë nëpërmjet platformës Pitagora dhe performancës përcaktuar publikut për lëndët artistike, por duhet të fillojë edhe kontrollin me sistemin elektronik dhe antiplagjiaturë të provimeve. Duhet thenë se në dy apo tre syllabuse ka vend për përmisim në sistemin e vlerësimit të studentëve.

Pergjigja e GRB te UART është : Për vete specifikën e programit të studimit Master I Arteve në Violinë dhe Mësuesi, i cili në lëndet me interpretim muzikor në kohë reale i realizon provimet me lojë live, para komisionit të provimit apo diplomës, me prezencë publike, (pra, jo me detyrë të mbyllura) pamundesohet objektivisht dukuria e kopjes apo e plagjiaturës në provime dhe detyra. Në lidhje me punimin teorik të tezës së diplomës, duhet nënvizuar fakti që ai është një material analize i formës kompozicionale dhe elementëve stilistikorë e estetikë, mbi vepren e përzgjedhur për t'u interpretuar live gjatë provimit të diplomës, i cili zëbërthen dhe ndërton logjikën dhe etapat interpretative në tere kohezgjatjen e saj. Për sa me lart, GVB do të sugjerojë përmes Departamentit të Interpretimit dhe Dekanatit të FM që Universiteti i Arteve të mundesojë një

*platformé antiplagjiaturé për verifikimin e punimeve teorike apo diplomave për t'u përdorur sipas nevojave që mund të dalin nga Departamentet e ndryshme të vete Universitetit apo organet e tij drejtuese.*

*Përgjigja nga GVJ : Në RVJ është vlerësuar shumë procedurat e vlerësimit të hapur të studenteve për anën artistike si në provime ashtu edhe në mbrojtjen finale. Grupi mendon se për pjesën teorike të lëndëve duhet të fillohet edhe me kontrollin elektronik, pasi kushtet e sotme të zhvillimit të teknologjive e ofrojnë një gjë të tillë, dhe që institucioni i ka zbatuar gjatë kohës së pandemisë. Ndërsa për përdorimin e platformës antiplagjiature në nivelin Master për pjesën teorike është një detyrim institucional, që duhet të zbatohet për sigurimin e cilësisë së punimeve.*

**Lidhur me fushën VI Standarti VI.2 Konkluzione,** në raport shkruhet : *GVJ lidhur me këtë standart mendon se përmbushet plotësisht pasi institucioni ka dhe zbaton si politika ashtu edhe procedura që realizojnë sigurimin e cilësisë nepermjet strukturave të ngritura dhe që funksionojnë. Konstatohet se në përberjen e njësive të sigurimit të cilësisë nuk ka një ekspert të jashtëm.*

*Përgjigja e GRB të UART është : GVB duke vlerësuar mendimin e GVJ për përmbushjen plotësisht të këtij standardi, sqaron se: UART është Institucion ku studiohet Art i cili ka angazhuar dhe përfshirë në mesimdhënie ekspertët më të mirë të fushës me titujt më të lartë akademikë dhe pa tituj por me veprimtari artistike kombëtare dhe ndërkombëtare. Pjesë e këtij stafi janë anëtarë të njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë.*

*Përgjigja nga GVJ : GVJ është njohur me një fakt të tillë edhe gjatë vizitës në takimet e bera me GVB dhe grupet e tjera, ndaj mendohet se mund të ndryshohet në raport ky konkluzion duke rekomanduar që të shkruhet edhe formalisht eksperti në përberjen e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe në raportet e tyre.*


**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Master Arteve në “Violine dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i**  
**Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve Tiranë”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti I Arteve Tiranë UART
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Interpretimit në Fakultetin e Muzikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve “Violine dhe Mësuesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhërit ë MASR Nr. 821, date 26.12.2018 “Per riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dyte në Universitetin Arteve
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	ska
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	ska
8	Cikli i studimit:	Niveli dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 I Kornizës kombëtare të Kualifikimit
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Stafi akademik PAE dhe PAK 2019 – 2020 15 PAE dhe 6 PAK 2020 - 2021 19 PAE dhe 6 PAK 2021 - 2022 17 PAE dhe 3 PAK
18	Numri i studentëve:	Rregjistruar Diplomuar 2019- 20 9 st. 4 st. 2020- 21 12 st. 8 st. 2021- 22 7 st. 0 st.
19	Komente / të tjera:	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)**

Universiteti i Arteve Tiranë (UART) themeluar më 1966, si Instituti i Lartë i Arteve i cili bashkoi tre institucione artistike: Konservatorin Shtetëror të Tiranës, Shkollën e Arteve të Bukura, dhe Shkollën e Lartë të Aktorëve "Aleksandër Moisiu". Më 1990, me ndryshimet në sistemin arsimor, Instituti i Lartë i Arteve u ngrit në nivel Universiteti dhe u emërua "Akademia e Arteve". Me VKM nr. 234, date 23.03.2011, u krijua Universiteti i Arteve mbi bazen e Akademise se Arteve, duke ruajtur të pandryshuar strukturën e fakulteteve.

UART ka tre fakultete: Fakultetin e Muzikës, Fakultetin e Arteve të Bukura, dhe Fakultetin e Artit Skenik. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 145, date 10.03.2021, i jepet Statusi i veçantë si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë. Fakulteti i Muzikës si një nga njësitë kryesore të UART-së, përbëhet nga tre departamente: "Departamenti i Interpretimit", "Departamenti i Kompozicion Muzikologji Dirizhim Pedagogji" dhe "Departamenti i Kantos". Fakulteti i Muzikës, në komunikim të ngushtë me Ministrinë përgjegjëse për Arsimin, argumentoi, kërkoi dhe iu akordua, përmes Urdhrit të MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve ", mundësia të perditësojë ofertën akademike duke ofruar studimet e ciklit të dytë në Master në Arte dhe Mësuesi.


Programi i studimeve Master i Arteve në "Violinë dhe Mësuesi" u ofron studentëve dije, njohuri të thelluara artistike kërkimore e zbatuese, kjo e fundit nëpërmjet praktikave konkrete, për një punë të kualifikuar në fushën e artit por dhe në mësimdhënie. E vecanta e këtij programi është se synon të pajisë studentët me nivelin e duhur shkencor e metodik në funksion të mësimdhënies, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë thellimit të njohurive mbi baza shkencore në të gjitha lëndët e mësimdhënies si dhe rritjes së nivelit profesional. Ky program realizohet në dy vite akademike dhe ka 120 kredite në përputhje me Ligjin 80/2015 Per arsimin e Lartë dhe Kerkimin Shkencor.

Stafi i këtij fakulteti është i kualifikuar dhe me një eksperiencë të madhe në fushën e muzikës në rang kombëtarë dhe më gjërë. Nga 82 pedagogë që japin mësim në këtë fakultet 17 kanë titullin "Profesor", 16 pedagogë kanë titullin "Profesor i asociuar", 8 pedagog kanë gradën shkencore

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



“Doktor i Shkencave” dhe 41 pedagog janë të kategorisë “ Asistent-Lektor” që nënkupton se 50% e stafit janë me tituj dhe grada shkencore.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

***Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:***

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- MASR, shkresa e saj, zyrtare Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve”.
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

Ekipi i përcaktuar nga ASCAL për vlerësimin e jashtëm të këtij programi, në përbërje : Prof. Gëzim Dibra, Prof. Assoc. Besa Luzha dhe ekipi nga ASCAL.Pas formalizimit të rolit të tyre sipas legjislacionit dhe procedurave përkatëse kanë kryer këto veprime:

- Analizuan dokumentacionin e programit në akreditim, të qasshëm përmes qasjes në sistem prej 15.11.2022

Realizuan vizitën në institucion në periudhën 13 dhe 14 Dhjetor 2022 dhe realizuan takimet:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të Departamentit që mbulon programin e studimit
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program
- Takim me studentë të këtij programi
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit, të Studentëve, Këshillimit dhe Karrierës, Alumni.
- Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Takim me Përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore
- Vizitë në Sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe në bibliotekë
- Takim përfundimtar me Përgjegjës të Departamentit

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Takimet u realizuan sipas agjendës së planifikuar dhe bisedat u zhvilluan në atmosferë të hapur, interaktive duke sqaruar pikat e identifikuar nga vlerësuesit. Në fund, u vëzhguan edhe ambientet: sekretaria (ku u verifikua edhe dokumentacioni përkatës), biblioteka, auditoriumet, sallat, ushtrimoret.

## **Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve “Violinë dhe Mësuesi”**

### **I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” ofruar pranë Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve bën pjesë në përgatitjen dhe formimin universitar të institucionit dhe ka synim një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm të formimit me karakter akademik, artistik dhe shkencor në fushën e arteve Nga përmbajtja (syllabuset) si dhe nga strukturimi (sipas veprimtarive ABCDE) si vazhdimësi e programeve bachelor që ofrohen nga ky departament, ky program nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe krijon mundësi dhe potenciale për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare. <sup>1</sup> Nga ana tjetër edhe personeli akademik me kohë të plotë dhe ai i angazhuar me kohë të pjesshme, pjesë e stafit të këtij program studimi, janë pjesë e përfaqësimit në nivele të larta të vlerave akademike e sidomos atyre kulturore në shkallë kombëtare e më gjërë. <sup>2</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” i Departamentit të Interpretimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e Universitetit të Arteve e shprehur në Statutin e Universitetit të Arteve, në nenin 4 të tij.

<sup>1</sup> Ligji 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kerkimin Shkencor. (Ref.nr.I.I.1.1.1.); Plani Mesimor Master Violë (Ref.nr.I.I.1.1.1.5.)

<sup>2</sup> Jeteshkrimet e Personelit Akademik të DI. (Ref.nr.I.I.1.1.1.6.)

<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Nga analiza e bërë strategjisë së zhvillimit të institucionit 2018-2025, rezulton se programi i studimit të nivelit të dytë Master I Arteve në “Violine dhe mësuesi” është në përshtatje dhe në zbatim të saj, si dhe statutit të këtij institucioni.</p> <p>Ky program studimi është hartuar në përputhje edhe me fushën e veprimtarisë të këtij institucioni që është Arti dhe në mënyrë me specifike, me fushën e Artit Muzikor, në përputhje edhe me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Nga analiza e planit mësimor rezulton se ky program studimi ka të integruar edhe element të masterit në fushën e mësuesisë, me lëndë për një formim profesional që përbëjnë 30 kredite, duke synuar që të përbushë kërkesat që burojnë nga ligji për programin Masteri në Arte, për studime të thelluara në fushën shkencore, por edhe duke sjellë një risi duke synuar që të realizojë edhe studime në aspektin profesional të mësuesisë.<sup>3</sup></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni rezulton se programi i studimit Master i Arteve në “Violin dhe Mësuesi” zhvillohet sipas strategjisë kombëtare të zhvillimit 2015-2020 miratuar në Maj 2016, strategjisë kombëtare për zhvillimin e arsimit 2021-2026 si dhe një sërë aspektesh të tjera që lidhen me garantimin e një arsimit cilësor dhe gjithpërfshirës, ndërkombëtarizimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje.<sup>4</sup></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe të verifikuar gjatë vizitës mendon se lidhur me standardi I.1 programi i studimit që ofron institucioni i arsimit të lartë Universiteti i Arteve Tiranë është në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b></p>	
<p><b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>


<sup>3</sup> Plani Mesimor Master Violë (Ref.nr.03 )

<sup>4</sup> <https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/>,

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur nga Departamenti i Interpretimit si dhe nga analiza e burimeve njerëzore të Fakultetit të Muzikës rezultoi se ky këto dy njësi kanë një staf akademik me përvijë shumëvjeçare me tituj dhe grada shkencore të mjaftueshëm për të ofruar dhe mbuluar programin e studimit Master i Arteve në Violin dhe Mësuesi. Numri prej 11 pedagogëve me titull shkencor Profesor, 12 pedagogë me tituj shkencor Prof.ass. dhe 5 pedagogë me gradën shkencore Doktor, pjesë e stafit të brëndëshëm të Departamentit të Interpretimit që mbulon programin me një background artistik të njohur në vite, është një granci për përmbushjen e qëllimeve të këtij programi studimi.<sup>5</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga analiza e planeve mesimore të programit të studimit të nivelit të dytë Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” dhe planeve të nivelit bachelor që mbulon njësi kryesore Fakulteti I Muzikës, rezultoi se programi është në një linjë me fushën akademike të njësisë kryesore, e përdituar në përputhje me klasifikimin dhe kodifikimin sipas direktivave dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe atyre evropiane. Një verifikim në rregulloren e studimit të institucionit në kreu i V, Kërkimi artistik Shkencor ( në nenet 42;43;44) si dhe në rregulloren e programit Master I Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, rezultoi se edhe kërkimi artistiko shkencor, synim i këtij program, është në përputhje me veprimtarinë dhe fushën kërkimore të njësisë kryesore dhe të institucionit.<sup>6</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke ju referuar International Standard Classification of Education (ISCED), rezultoi se programi i studimit të nivelit të dytë Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” është në përputhje me fushën akademike kërkimore (Arte kodi 021 si fushë e përgjithshme dhe Muzike dhe arte performuese kodi 0215 si fushë specifike) të njësisë bazë që është Departamenti I Interpretimit pranë Fakultetit të Muzikës.<sup>7</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Universiteti i Arteve nuk ofron “Master profesional” në një drejtim specifik jashtë profilit të institucionit</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e</p>	<p>Fakulteti i Muzikës si pjesë e Universitetit të Arteve, për vetë specifikën dhe pozicionin e tij në jetën kulturore të vendit, ofron bashkëpunimin e</p>

<sup>5</sup> Tabelat e personelit akademik (Ref.nr.I.I.1.2.3.)


<sup>6</sup> Rregullore e studimit UART ( ref.nr.I.I.1.3.7.)

<sup>7</sup> International Standard Classification of Education: Fields of Education and Training 2013” UNESCO. (Ref.I.I.2.2.1.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	personelit të vet akademik interpretues me institucionet kryesore artistike të vendit, si TKOBAP dhe institucione jopublike. <sup>8</sup>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ duke u mbështetur në dokumentat e paraqitur dhe të verifikuar gjatë vizitës është i mendimit se programi i studimit Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Në institucion ekziston një strukturë e brendshme funksionale që bën të mundur të përmbushë qëllimet e misionit të institucionit konform ligjit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga GVB konstatohet se institucioni ka hartuar dhe miratuar një sërë udhëzimesh dhe rregulloresh të cilat sigurojnë një bashkëpunim dhe ndarje detyrash mes njësive dhe administratës për mbarëvajtjen e programit të studimit. Në statutin e institucionit në disa nene të tij si dhe në rregulloret e tërë njësive të institucionit janë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse të punës, dhe bëhet një analizë e vazhdueshme e rezultateve të arritura. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se kishte një bashkëpunim efektiv mes këtyre njësive dhe njohje e plotë e detyrave dhe detyrimeve që ato kishin. <sup>9</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Fakulteti i Muzikës si njësi përbërëse e Universitetit të Arteve Tiranë rezulton se ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi reciprok në kuadrin e projekteve evropiane ERAZMUS+, marrëveshje për diploma të përbashkëta, memorandum mirëkuptimi, me universitete homologe jashtë vendit. Gjatë takimit me përfaqësuesin e njësive për projekte u njohëm edhe me hapjen e programeve të përbashkëta me universitete homologe jashtë si

<sup>8</sup> Faqja zyrtare e UART <http://www.uart.edu.al>; Vendimi I SA nr 60, date 13.9.2022 për aprovimin e Rregullores së Programit të Studimit Master i Arteve Violinë dhe Mësuesi. (Ref.nr. 01)

<sup>9</sup> Statuti i Universitetit të Arteve, **Neni 9, 11, 12, 13**, - UART dhe njesite perberese te tij, **Neni 21** - Biblioteka e UART **Nenet nga 22 deri ne 44** -Organet dhe autoritetet drejtuese, **Nenet nga 46 deri ne 52** – Struktura administrative ne UART, **Nenet 53 deri ne 61** Personeli akademik.( Ref.nr. I.I.1.2.1)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Universiteti i Arteve Fakulteti i Muzikës Tiranë me Conservatorio Supenor de Musica de Vigo Spanjë (Bachelor dhe Master) ; Universiteti i Arteve me Dipartimento Arti, Musica, Spettacolo Universita' "Aldo Moro" Bari, Itali (Bachelor) ; Universiteti i Arteve me Universita' "Tor Vergata" Roma, Itali (PHD).<sup>10</sup></p> <p>Fakulteti I Muzikës rezulton se ka realizuar disa marrëveshje me biznese apo shoqata për përmisimin e infrastrukturës së njësisë në shërbim të rritjes së performancës dhe cilësisë së mësimdhënies në programet që ofron.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga verifikimi I dokumentacionit dhe verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezulton se Fakulteti i muzikës ka një sërë marrëveshjesh në ndihmë të përmisimit të procesit mësimor. Janë bërë përpjekje edhe për të realizuar marrëveshje për praktikën profesionale e cila është e një natyre të vecantë, pasi lidhet me pjesmarrjen e studentëve në veprimtari apo aktivitete që realizohen nga institucione të caktuara kulturore si Teatri Kombëtar I Operas dhe Baletit, Ansambli Popullor etj, Ndonëse është paraqitur një tabelë nr.5 lidhur me marrëveshjet me institucione dhe organizata bashkëpunuese në rang programesh, dhe një evidencë marrëveshjeje me ZVA Vlorë për realizimin e praktikës profesionale të studentëve, gjatë takimit në institucion u njohëm edhe me dokumenta të tjerë që tregonin për marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha ZVA-të ku studentët kanë bërë apo do të bëjnë praktikën mësimore.<sup>11</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga verifikimi i bërë në Departamentin e Interpretimit rezulton se ka përfitime nga marrëveshjet e realizuara me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si mobilitete studentësh dhe pedagogësh, por nuk rezulton se ka raporte periodike lidhur me keto përfitime. Ka një listë ku evidentohen mobilitetet por jo analizë se sa kanë ndikuar këto përfitime në realizimin e programit në fjalë.<sup>12</sup></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ mendon se lidhur me këtë standart nisur nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion rezulton se ka UART dhe Fakulteti I Muzikës si pjesë e tij ka një sërë marrëveshjesh me universitete dhe institucione të tjera që ndihmojnë për një cilësi në realizimin e programit të studimit Master I Arteve në "Violinë dhe Mësuesi" si dhe për një aftësim profesional si artistik ashtu edhe mësimdhënës. UART ka programe studimi dypalëshe me partnerë të haj që është një garanci më shumë për realizim cilësor të programit. Konfirmojmë se standarti përmbushet plotësisht</p>

<sup>10</sup> UART AGDER marrëveshja e bashkëpunimit në kuader të programit Erasmus+ KA- 107 (Ref.nr.I.I.3.2.1.), UART CSM VIGO marrëveshja e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus+ KA- 107 (Ref .nr.I.I.3.2.2.), UART RCSM GRANADA marrëveshja e bashkëpunimit në kuader të programit Erasmus+ KA- 107 (Ref.nr. 11.3.2.3)

<sup>11</sup> Tabela 5 Aneks RVB Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese. (Ref.nr.I.I.3.3.1.), Faqja zyrtare e UART. Faqja zyrtare e UART <http://www.uart.edu.al>; Marrëveshje me ZVA Vlorë (model) (Ref.nr.II.2.2.1.)

<sup>12</sup> Statistikat e pergjithshme te International Credit Mobility ( Ref.nr. I.I.3.4.1.)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga analiza e bërë planit mësimor të programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, konfirmojmë se plani mësimor është hartuar duke u bazuar në VKM Nr.41, date 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar; Urdhrin e MASR Nr. 821, date 26.12.2018 “Per riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve, si dhe në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) Veprimtaritë formuese pjesë e këtij plani mësimor ABCDE janë konform udhëzimeve të MARS dhe përfaqësisht me përqindjet që kërkohen sipas këtyre udhëzimeve. <sup>13</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike	Nga analiza e programi të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” që ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve; rezulton se struktura e ndërtimit dhe përmbajtja e tij qëllimi dhe objektivat, realizojnë formimin e shprehive të veçanta si në fushën e muzikës ashtu edhe në fushën e mësimdhënies. Në planin mësimor lëndë të përfshira në veprimtaritë formuese B mundësojnë përvetësimin nga studentët si përvetësimin e teorive dhe parimeve akademike në fushën e muzikës ashtu edhe formimin e tyre me mjeshtërinë e ekzekutimit dhe interpretimit të veprave në tërësinë e

<sup>13</sup> VKM Nr.41, date 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar ( Ref.n. II.1.1.1.);Urdhrin e MASR Nr. 821, date 26.12.2018 “Per riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve, (Ref.nr. II,1,1,2,) Plani mesimor Viole dhe mesuesi (Ref.nr.03)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>stileve muzikore. Si edhe u verifikua nga vizita në institucion numri I të punësuarve mbi 90 % të diplomuarve konfirmon se studentët e diplomuar kanë aftësitë dhe kompetenca për tu përgjigjur kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Nga ana tjetër një analizë e syllabusve të veprimtarisë formuese A tregon se këto veprimtari japin mundësi studentëve të marrin njohuri dhe të formojnë shprehje dhe kompetenca në aspektin profesional në fushën e mësuesisë.<sup>14</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga verifikimi i programi të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” që ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve rezulton se ky program është realizuar konform udhëzimeve të MAS-së dhe udhëzimeve të vetë institucionit për praktikën profesionale dhe detyrimet mbyllëse. Në planin mësimor janë planifikuar dy praktika si ajo profesionale për mësimdhënien me 3 javë, dhe praktika artistike me ngarkesën 30/20 gjithsejt të dyja me 8 ECST. Rezulton se praktika mësimdhënien behet në shkolla sipas marrëveshjeve me ZAV-të ndërsa praktika artistike rezulton të behet nga përfshirja e studentëve në jetën koncertale të fakultetit të Muzikës. Ndërsa po në këtë plan detyrimet mbyllëse janë përcaktuar me një ngarkesë 2 orë në javë dhe 520 orë punë individuale të studentit me 22 ECTS.<sup>15</sup></p> <p>Gjatë vizitës në takimin me stafin dhe studentë u konfirmua se në semestrin e 4, ngarkesa 2 orë në javë në auditor është edhe një mundësi takimi më udhëheqësin si dhe për të kontrolluar ecurinë e punës së studentit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nga analiza e programeve të studimit të nivelit bachelor në Violinë me programin Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, mund të konfirmojmë se ka një vazhdimësi si nga ana strukturore por edhe në përmbajtje duke u bazuar si në qëllimet ashtu edhe objektivat e këtyre planeve. Dizenjuar si Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” ai është në përputhje me ligjin 80/2015 dhe udhëzimet e MAS-së, duke synuar formimin shkencor dhe profesional të studentëve si si artistë dhe si mësues.<sup>16</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve në planin mësimor rezulton se Programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” është i organizuar</p>

<sup>14</sup> Plani mesimor Violine dhe mesuesi (Ref.nr.03); Syllabuset e Planit mesimor Violine dhe Mesuesi ( Ref.nr.01 )pdf. Regullore e studimeve te programit te studimit Mster i Arteve ne Violine dhe Mesuesi neni 2;3;5.(Ref.nr.01)pdf.

<sup>15</sup> Plani mesimor Violine dhe mesuesi moduli E (Ref.nr.03); Marrëveshje me Drejtoritë e Pergjithshme të ZVA Vlorë (Ref.nr. II.1.3.4.); Vizita ne UART takimi me studente dhe staf akademik.

<sup>16</sup> Plani mesimor bachelor Virole (Ref.nr.II.1.4.1.) ; Plani mesimor Violine dhe mesuesi (Ref.nr.03).

<p>25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>sipas ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe shtojcës 1 të VK.M Nr. 41, date 24.01.2018 Per elementët e programeve të studimit te ofruara nga IA.L e ndryshuar. Ky program është më një kohzgjatje dy vite dhe ka 120 kredite. Veprimtaritë formuese A ( Lëndë bazë -përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme ) përbëjnë 24 ECTS por duke marrë si formim profesional edhe praktikën me 6 ECTS, bëhen gjithsejt 30 ECTS, duke plotësuar 25% të krediteve të kërkuara për këto programe studimi që përgatisin edhe mësues.<sup>17</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga grupi i vlerësimit të brëndëshëm rezulton se forma e organizimit të programit të studimit është me kohë të plotë në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 (neni 75.pika 4); Statutit të Univeritetit të Arteve, si dhe rregullores se studimeve të këtij programi. Pranimi i studentëve bëhet me konkurs bazuar në rregulloren e programit të studimeve ( neni 11), në kriteret e përcaktuara e të miratuara nga Fakulteti i Muzikës ( shkresa Nr. 20/2. date 21.01.2022 ), në përputhje me nenin 76.pika 1;2;3, të ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe nenit 92 të statutit të institucionit.Rezulton se ka një rregullore të miratuar nga fakulteti dhe Senati për realizimin dhe procedurat e zhvillimit të konkursit të pranimit, dhe se kjo rregullore dhe procedurat publikohen në faqen zyrtare të UART-ve<sup>18</sup> Rezulton se financimi i këtij programi studimi bëhet nga Departamenti i Interpretimit në përputhje me Statutit e institucionit (Neni 92/7), edhe VKM 780 datë 26.12.2018.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” rezulton se ofrohet vetëm në Departamentin e Interpretimit të Fakulteti i Muzikës të Universiteti të Arteve. Në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 ai është i ngjashëm me të gjithë Masterat e Arteve në Mësuesi që ofron kjo njësi duke përmbushur mbi 90% të programit të njëjtë sic kërkohet për mastera në të njëjtën fushë studimi, që ofron ky departament.<sup>19</sup></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” rezulton se ky program shoqërohet me kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra nga MAS. Programi përfshihet në fushën e studimit Arte dhe Shkencave Humane (kodi 02), si fushë e përgjithshme Arte (kodi 021) dhe fusha specifike Muzike dhe arte performuese (kodi 0215)</p>

<sup>17</sup> Urdher i MASR Nr. 821, date 26.12.2018 “Per riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dyte ne Universitetin Arteve” (Ref.nr.II.1.5.1.); VK.M Nr. 41, date 24.01.2018 Per elementët e programeve të studimit te ofruara nga IA.L e ndryshuar (Ref.nr. I.I.2.2.2.)



<sup>18</sup> Ligji 80/2015 Per arsimin e Larte ( Ref.nr.I.I.1.1.1.); Statuti i UART neni 91;92.(Ref.nr.II.1.6.2.); Rregullore e studimit te programit Master i arteve ne Violine dhe mesuesi ( Ref.nr.01);

<sup>19</sup> VKM 145 Per dhenien e Statusit te veçante Universitetit te Arteve (Ref.nr.II.1.7.1.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” Kode M2VLN1101; M2VLN1201; M2VLN1399</p> <p><i>Në shqyrtimin e syllabesve të planit mësimor rezulton se ka programe lëndësh kryesisht në veprimtaritë formuese A që nuk janë të kodifikuara apo jo në formatin e të tjerëve.<sup>20</sup></i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Rezulton se ky program nuk është program i përbashkët.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ mendonse lidhur me këtë standart programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” është tërësisht në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, (neni 75.pika 4) statutit të Univeritetit të Arteve, si dhe rregullores se studimeve të këtij programi.</p> <p>Veprimtaritë formuese ( modulet ) A,B,C,D,E janë të organizuara në përqindjen që kërkohet sipas udhëzimeve.</p> <p><i>Rezulton se 3 nga 5 lëndët e modulit A Lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme nuk janë të plotësuara sipas formatit që është dhe nuk janë të kodifikuara.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p><b>Standardi II.2</b>  <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit konfirmojmë se njësia kryesore bazë për programin e studimit Masteri Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, Fakulteti i Muzikës funksionon konform legjislacionit në fuqi. Fakulteti i Muzikës ka në përbërje të vet 3 Departamente: Departamentin e Interpretimit Departamentin Kompozicion, dhe Departamentin e Kantos, duke përmbushur detyrimin e përcaktuar në Ligjin 80/2015, Neni 23/2. Departamenti i Interpretimit si njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi është konform ligjit dhe ka në një staf akademik prej 48 anëtarësh prej të cilëve 11 me titullin Professor; 12 me titullin Prof. i asociuar, dhe 5 me gradën shkencore Doktor.<sup>21</sup></p>



<sup>20</sup> VKM Nr. 330, date 11.05 2022 “Per specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucione! e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. (Ref.nr. II.1.8.3.); UNESCO Standartet Nderkombëtare të Klasifikimit të Arsimit, (Ref.nr.II.1.8.2 ; Syllabuset moduli A ( ref.nr.01.)

<sup>21</sup> Tabela e personelit akademik të Fakultetit dhe DI (Ref.nr.II.2.1.3.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga verifikimi i të dhënave në RVB dhe në takimin me drejtues te fakultetit, departamentit si dhe me Drejtorinë e Burimeve njerëzore rezulton se njësia bazë e programit të studimit Master i Arteve në “Violine dhe Mësuesi”, angazhon personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore. Angazhimi i personelit akademik bëhet me urdhër te brendshëm sipas rregullores se brëndëshme të institucionit. Deklarimet e bëra nga grupi i punës i RVB-së ; Urdheri i brendshëm per angazhimin e personelit akademik për realizimin e praktikave mësimore; Skeda e studentit praktikant; Marreveshja e praktikës; Formulari i vlerësimit per studentin u verifikuan gjatë vizitës.<sup>22</sup> Institucioni angazhohet dhe vë në dispozicion laboratorët dhe infrastrukturën teknologjike për përgatitjen e tezave dhe të detyrave përgjatë arritjes së qëllimeve dhe objektivave të programit. Institucioni ka personel ndihmës për pajisjet e teknologjisë mësimore dhe mirëmban pajisjet kompjuterike në laboratorin e informatikës.Numri I punonjësve ndihmës për laboratorët dhe teknikës është 7 dhe janë të diplomuar në profilin e studimeve që ofron universiteti.<sup>23</sup></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Konfirmojmë se ka një program lënde për praktikën artistike dhe mësimdhënies pra rezulton se njësia përgjegjëse e këtij programi studimi ka caktuar nga një përgjegjës për realizimin e tyre.Ndonëse në syllabuset e planit mësimor nuk ka një të tillë për praktikën mësimdhënëse, në takimin me drejtorin e njësisë bazë na u konfirmua përsonei që mbulonte këtë praktikë.<sup>24</sup></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ mendon se njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, ka një personel të mjaftueshëm ndihmës si akademik dhe administrativ të mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit, dhe ka organizuar praktikat si artistike ashtu edhe mësimore në përputhje me rregulloret e institucionit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<sup>22</sup> Urdher i brendshëm per angazhimin e personelit akademik per realizimin e praktikave mësimore(Ref.nr.II.2.2.2.); Skeda e studentit praktikant model (Ref.nr.II.2.2.3.); Formulari I vlerësimit per studentin praktikant model, (Ref.nr.II.2.2.5.)

<sup>23</sup> Vizita ne ambientet te institucionit.

<sup>24</sup> Urdher I brendshem per angazhimin e personelit akademik per realizimin e praktikave mësimore,(Ref.nr.II.2.3.2.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga verifikimi i dokumentacionit që disponon njësia kryesore e programit të studimit rezulton se Fakulteti i Muzikës ka tërë informacionin e nevojshëm si për organizimin e programit ashtu edhe për strukturën dhe përmbajtjen e tij. Fakulteti disponon të gjitha vendimet e marra nga Senati për organizimin e këtij programi, rregulloren e studimit të këtij program ku përcaktohen në detaje struktura, dhe përmbajtja, rregullorja e pranimit me kriteret dhe procedurat e realizimit të konkursit, etj. Në RVB të gjithë këto dokumenta janë pasqyruar me evidenca, por janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të UART-së. <sup>25</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Konfirmojmë se pjesë e këtij programi të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” është edhe plani mësimor i detajuar sipas udhëzimeve të MAS-së dhe të rregulloreve të miratuara për këtë program studimi. Në planin mësimor ndarja e lëndëve është bërë sipas të VK.M Nr. 41, date 24.01.2018 Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga IA.L e ndryshuar. Janë të pasqyruara ngarkesa e lëndëve, raporti brenda dhe jashtë auditorit, pikët kredite etj. <sup>26</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e studimit të programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” të miratuar në Senatin Akademik me vendimin Nr.58 datë 13.09.2022, si dhe rregullorja e konkursit të pranimit Nr.20/1 datë 02.01.2022, rezulton se ka tërë informacionin e nevojshëm lidhur me pranimin e studentëve (neni 12), transferimin e tyre (neni 24). Në vizitën në institucion në takim me sekretarinë mësimore dhe me studentët u konfirmua se në rregulloren e këtij programi studimi të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të fakultetit, studentët marrin tërë informacionin e plotë lidhur me konkurset e pranimit ashtu edhe ekuivalentimin e studimeve ( në rastet e mobiliteteve të studenteve në kuadrin e projekteve Erasmus ) apo edhe transferimin e studimeve, ndonëse nuk ka asnjë transferim. <sup>27</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore	Departamenti i Interpretimit si përgjegjës i realizimit të këtij programi studimi zotëron të programet lëndore syllabuset pjesë e planit mësimor të

<sup>25</sup> Rregullore dhe kriteret për studimet master viti 2022-2023. (Ref.nr.II.3.1.5.); Vendimi I SA nr 60, date 13.9.2022 për aprovimin e Rregullores së Programit të Studimit Master i Arteve Violinë dhe Mësuesi.(Ref.nr. II.3.1.2.); Faqja zyrtare e UART <http://www.uart.edu.al>;

<sup>26</sup> Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Violinë dhe Mësuesi (Ref.nr.II.3.2.1.); VK.M Nr. 41, date 24.01.2018 Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga IA.L e ndryshuar.( Ref.nr.II.2.2.2.);

<sup>27</sup> Rregullore mësimore e Ciklit të dytë të studimeve Master.(Ref.nr.II.3.3.4.); Rregullore e konkursit dhe kriteret për studimet master viti 2022-2023.(Ref.nr. II.3.3.5.);Faqja Zyrtare UART <http://www.uart.edu.al>;

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




(syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	programit të hartuara sipas udhëzimeve dhe rregullores së këtij program studimi, si elementet e kërkuar sipas VKM Nr. 41 date 24.01.2018 i ndryshuar dhe formatit të miratuar në nivel institucioni: <i>Konstatohet se një dy apo tre programe lëndore janë jo të përdituar, (Psikologji Zhvillimi pa kodifikim; Metodologji mesimdhënie dhe Teori të nxënies e menaxhim klase tjetër format); jo sipas formatit të miratuar nga vetë departamenti.<sup>28</sup></i>		
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Ndonëse ka një analizë që bëhet për realizimin dhe cilësinë e programit të studimit Master I Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” nga njësi bazë dhe komisioni I ngritur për sigurimin e cilësisë, të miratuar nga Rektori dhe të dërguar më pas njësisë përgjegjëse, nuk ka patur asnjë ndryshim në këtë program.		
<b>Konkluzione</b>	Mendojmë se Programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” është i organizuar dhe strukturuar në përputhje me objektivat formuese të një programi të nivelit të dytë, duke përbushur të gjitha kriteret që kërkohen. <i>Konstatohet se një dy apo tre programe lëndore janë jo të përdituar, apo nuk janë sipas formatit të miratuar nga vetë departamenti sipas udhëzimeve të marra, apo nuk kanë të gjithë elementët e kërkuar. Programet e lëndëve paraqitura ka që janë edhe 2019-2020 dhe ,nuk ka asnjë program të 2021-2022.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		<b>X</b>	

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënies, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur rezultojnë se programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” i ofron studentëve orë të nevojshme e të mjaftueshme teorike e praktike për një thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme por edhe punësimin e tyre. Gërshtëtimi i lëndëve pedagogjike më ato artistike ndihmon në

<sup>28</sup> Syllabuset e Planit Mësimor të Programit të Studimit Master i Arteve Viole dhe Mësuesi, moduli A lëndet baze, ( Ref.nr.03)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>aftësimin e zhvillimin e tyre profesional për punësimin e tyre të ardhshëm. Ky program studimi është një vijim i thelluar i njohurive të marra në nivelin e parë të studimit Bachelor për duke patur si risi ofrimin për studentë të mundësinë të marrin informacion në fushën didaktike e praktike të mësimdhënies.<sup>29</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” është strukturuar në veprimtari formuese A;B;C;D;E që realizohen në një shtrirje kohore 2 vjecare me 4 semestra me 120 kredite (ECTS) Vlerësimi i punës së studentëve është 25 ore për një kredit dhe nënkupton si vlerësimi i punës në auditor ashtu edhe punën e pavarur të tyre jashtë auditorit. Mendojmë se duhej të ishin evituar lëndë me një ngarkesë mësimore 25 ore pra me një kredit, pasi nuk janë të përshtatshme për një nivel studimi master dhe duhet të kishte lëndë për aftësimin e studentëve për kërkimin shkencor në formë metodike kërkimi shkencor. Mendojmë se ky strukturim i planit mësimor mundëson realizimin e objektivave të këtij programi, si dhe arritjen e rezultateve të pritshme të të nxëniet.<sup>30</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Rezulton se struktura e programit, plani mësimor si pjesë e tij, ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe bazuar edhe në eksperinca ndërkombëtare. Plani mësimor i programit ka dhënë shumë përparësi ushtrimeve apo seminareve në raportin teori praktikë, duke synuar zhvillimin e karrierës artistike të studentëve si dhe aftësimin në mësimdhënie për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Këtë e mundëson përfshirja në planin mësimor i lëndëve tërësisht të lidhura me psikologjinë dhe mësimdhënien.<sup>31</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Duke analizuar planin mësimor të programit të studimit Master I Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” në aspektin e raporteve mes lëndëve të shtrira sipas veprimtarive formuese dhe raportin teori praktikë brënda vetë lëndëve të një tipi veprimtarie, rezulton se ai i krijon mundësi studentëve jo vetëm që të kenë hapësira më të mëdha punësimi por edhe mundësinë për njohjen dhe transferimin e studimeve dhe realizimin e mobiliteteve në universitete homologe jashtë vendit. Rastet e verifikuar me dy studentë që</p>

<sup>29</sup> Plani mesimor I programit Master i Arteve ne Violine dhe Mesuesi. (Ref.nr. 03); Syllabuset e Planit mësimor te Programit te Studimit Master I Arteve ne Violine dhe Mesuesi. (Ref.nr.01); Plani mesimor Bachelor ne Violine (Ref.nr.I.I.1.1.14.)

<sup>30</sup> VKM nr 41, date 24.01.2018 “Per elementët e programeve të studitnit të ofruara nga institucionet e arsimit të larte” (Ref.nr. II.4.2.1.); Plani mesimr Master i Arteve ne Violine dhe Mesuesi (Ref.nr.03)

<sup>31</sup> Plani mesimor I programit Master i Arteve ne Violine dhe Mesuesi. (Ref.nr. 03); Syllabuset e Planit mësimor te Programit te Studimit Master I Arteve ne Violine dhe Mesuesi. (Ref.nr.01)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	kanë fituar mobilitete dhe njohjes së krediteve nga universitetet pritëse dhe punësime në sistemin arsimor i dy studentëve e konfirmon këtë gjë. <sup>32</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Pavarësisht se çfarë deklarohet në RVB-në e paraqitur nga grupi I punës që është e lidhur me natyrën dhe statusin e vecantë të programeve që ofron, nuk konsiston se ka një përditësim të programeve të lëndëve, e cila duhet të jetë e dokumentuar në mbledhjet e departamentit dhe miratimin e tyre çdo vit akademik Në shqyrtimin e programeve lëndorë gjatë tre viteve rezultojnë se ka një përditësim të literaturës, por jo ndryshime në përmbajtjen e programit. <sup>33</sup>			
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Nga analiza e përmbajtjes së programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” mund të konfirmojmë se mundëson formimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në përputhje me objektivat dhe synimet e përcaktuara në këtë program.Fakti që studentët janë pjesmarrës në koncerte dhe janë pothuajse tërësisht të punësuar si edhe u verifikua nga vizita në institucion, e konfirmon këtë gjë. <sup>34</sup>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Rezultojnë se përmbajtja e Programit të Studimit Master I Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” i jep mundësinë studentëve që janë diplomuar për të vazhduar studimet në nivelin e tretë të studimeve për doktoraturë.Ne <b>nenin 69 të rregullores së studimit të Universitetit të Arteve</b> theksohet se në studimet doktorale te nivelit të tretë mund të vazhdojnë edhe studentët që kanë fituar një diplomë në Master I Arteve.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ arrin në konkluzionin se struktura dhe përmbajtja e programit të studimeve Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe objektivat e programit, duke garantuar formimin e kompetencave si artistike dhe mësimdhënëse në përputhje me kërkesat e tregut të punës.Punësimi I të diplomuarve mbi 90% verifikuar gjatë vizitës e konfirmon këtë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

#### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<sup>32</sup>Statistikat e përgjithshme të International Credit Mobility.(Ref.nr.II.4.4.3.); Pjesmarrje ne mobilitete ne kuader te ERAZMUS+ ( Ref.nr. I.I.3.3.3.)

<sup>33</sup> RVB Master I Arteve ne Violine dhe Mesuesi ( **Standardi II.4. kriteri 5** )

<sup>34</sup> Plani mesimor Master I Arteve ne Violine dhe Mesuesi ( Ref.nr.03.); Syllabuset e planit mesimor Master i Arteve ne Violine dhe Mesuesi. (Ref.nr.01.);Faqja zyrtare e UART Rubrika “Aktivitete ne kohe reale” <http://www.uart.edu.al>.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur lidhur me programin Master i Arteve në “ Violinë dhe Mësuesi” rezulton se ky program është hartuar bazuar në urdhërin Nr. 616 datë 30.12 2016 dhe Nr. 821 datë 26.12.2018 I MAS-se për verifikimin e pershtatshmërisë të programeve të studimit të ciklit të dytë në fakultete të Universitetit të Arteve si dhe të vendimit të hapjes së këtij programi. Nga verifikimi I dokumentacionit mund të konstatohet se është bërë një punë e mirë për hartimin e tij duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës, dhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë si institucione homologe, të diplomuar, përfaqësues të institucioneve arsimore etj.<sup>35</sup></p> <p>Konstatohet se gjatë realizimit të këtij programi nuk është bërë ndonjë ndryshim i strukturës dhe përmbajtjes së këtij programi studimi.</p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës u konfirmua se Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit ku ofrohet programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, realizon një feedback me studentët dhe strukturat e tyre, mban dhe merr sugjerime nga studentët e diplomuar, shfrytëzon projektet e përbashkëta që ka me partnerë të huaj, me synimin për përmirësimin e programit të studimit,<sup>36</sup> por rezulton se reflektimi është bërë vetëm në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së syllabuseve.</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit ku ofrohet programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, deklaron se konsideron proces të përmirësimit, përditësimit dhe përshtatjen e programit të studimit, propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme, bashkëpunimin me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione, përvojën akademike të fituar si dhe shkëmbimet të personelit akademik në kuadër të mobiliteteve Erasmus+ KA 107, organizimit të Master classeve por nuk rezulton se ka ndonjë ndryshim, apo përshtatje të këtij programi, pasi ka pak vite që është hapur dhe rezultatet dhe objektivat janë arritur.<sup>37</sup></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ arrin në konkluzionin se njësia përgjegjëse organizon një sërë bashkëpunimesh dhe veprimtarish që synojnë përmirësimin e programit të studimit me një sërë aktorësh profesionistë të fushës, me pjesëmarrje në projekte me partnerë të huaj, por nuk rezulton se ka ndonjë ndryshim të këtij programi, pasi është arritur qëllimi dhe objektivat e programit.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<sup>35</sup> Ngritja e grupit te punes per shqyrtimin e programeve te Ciklit te Dyte.(Ref.nr.II.5.1.2.);Propozimet dhe rekomandimet e grupit te punes. (Ref.nr. II.5.1.3.)

<sup>36</sup> Analize nga NJSBC e pyetësoreve te studenteve. (Ref.nr.II.5.2.1.); Faqja zyrtare UART <http://www.uart.edu.al> (rubrikat “Alumini” dhe “Marreveshjet”)

<sup>37</sup> Statistika të Mobiliteteve Erasmus+ JC4 107 2020-2022. (Ref.nr.II.5.4,2,); Foto masterclasse. (Ref.nr.II.5.4.3.)

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe analizës së programëve të lëndëve të programit të studimit Master i Arteve në "Violinë dhe Mësuesi" rezulton se janë përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat e Universitetit të arteve, Fakultetit të Muzikës dhe Departamentit të Interpretimit. Përmbajtja e lëndëve dhe strukturimi i tyre janë në funksion të formimit të studentëve me bazat didaktike, muzikore dhe kulturore të koncertimit në violinë, rritjes së mjeshtërisë të ekzekutimit dhe interpretimit të veprave në tërësinë e stileve muzikore, aftësimi të tyre në mësimdhënie për të gjithë sistemin arsimor. <sup>38</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë si dhe me stafin akademik rezulton se ka një bashkërendim të tërë strukturave të angazhuara në realizimin e programit të studimit Master i Arteve në "Violinë dhe Mësuesi" ( të Sekretarisë mësimore, Sektorit mësimor dhe të kurrikulës, Burimet njerëzore, Zyra e projekteve, Zyra e informacionit protokoll /arkivës ) dhe orientim e mbështetje për veprimtaritë artistike dhe shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit të përfshirë në këtë program. <sup>39</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nga një analizë e veprimtarive të organizuara nga Fakulteti I Mësuesisë dhe Departamenti I Interpretimit rezulton se në Programin e studimit Master i Arteve në "Violinë dhe Mësuesi" studentët angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore si nëpërmjet detyrimeve që kanë gjatë vitit në lëndë të ndryshme por edhe nga pjesëmarrjes në aktivitetet artistike dhe kërkimore artistike që organizohen në Departamentin e Interpretimit apo dhe të Fakultetit të Muzikës. Konstatohet se studentët me të dalluar përzgjidhen dhe angazhohen në projekte bashkëpunimi me Orkestrën e TKOBAP, në Master Classet apo te sektorit jopublik, përmes OJF në fushën e muzikës. <sup>40</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e	Nga shqyrtimi i buxhetit të Universitetit rezulton se Fakulteti I Muzikës me miratimin e Bordit të Administrimit të UART ka mbështetur

<sup>38</sup> Rregullorja Mesimore e studimeve te ciklit të Dytë Master i Arteve ne Viole dhe mesuesi **Kreu I neni 1; 2;5** (Ref.nr.II.1.6.4.); Statuti UART **Kreu VII neni 91;93.** (ref.nr.I.I.1.2.1.)

<sup>39</sup> Statutii UART **Kreu VI neni 75 deri 80.** ( Ref.nr.I.I.1.2.1.)

<sup>40</sup> Takimi me studente gjate vizites.; Faqja zyrtare e UART <http://www.uart.edu.al> ( rubrika "Aktivitete" )

shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitetet të ndryshme.	Departamentin e Interpretimit në kuadër të pajisjes me instrumente muzikorë të tipologjive apo edhe në <b>aktivitetet kërkimore/artistike të festimit të 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës me dhënien e ambienteve të UART-së falas dhe mbulimin e materialeve logjistike dhe komunikimit.</b> Një ndihmesë e madhe për stafin akademik kanë qënë edhe mbështetja financiare nga projektet apo edhe nga organizimi I aktiviteteve të përbashkëta me partnerë të huaj në kuadrin e këtyre projekteve .		
<b>Konkluzione</b>	GVJ konfirmon se programi Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” ka përcaktuar prioritetet objektivat dhe qëllimet në aspektin e studimit dhe të kërkimit shkencor. Realizimi I tyre bëhet bazur në një bashkëpunim të efektshëm të tërë njësisve të UART-së dhe Fakultetit të Muzikës, duke përfshirë dhe nxitur aktivisht studentët në këtë proces.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Interpretimit, si pjesë e Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve dhe përgjegjëse e programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” rezulton se operon në koordinim me grupet lëndore që janë pjesë e strukturës së saj për realizimin e objektivave të programit të studimit që lidhen me kërkimin shkencor. Rezulton se njësia kryesore përgjegjëse për realizimin e programit, për vetë natyrën specifike që ka institucioni, ka mbështetur grupet mësimore në projekte shkencore dhe përfshirjen e të rinjve në projekte dhe produkte artistike e kërkimore në fushën e muzikes bashkëkohore. Gjatë vizitës GVJ u njoh me një sërë veprimtarish artistike që ka organizuar njësia me rrastin e 60 vjetorit të UART ku u theksuar se janë realizuar 60 ditë koncerte tërësisht me stafin dhe studentë të këtij institucioni, si dhe veprimtari të tjera artistike në bashkëpunim me pedagog të huaj edhe në kuadrin e Master Classeve. <sup>41</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin	Nga shqyrtimi I dokumentacionit, Departamenti i Interpretimit, si pjesë e Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve dhe përgjegjëse e programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” rezulton se aktualisht është e angazhuar nepërmjet strukturave të saj në projekte kërkimore, si në kuadër të financimeve të huaja apo vendase, ashtu edhe

<sup>41</sup> Faqja zyrtare e UART <http://www.uart.edu.al>. ( rubrika “Aktivitete” ); Foto nga koncerte, masterclasse (Ref.nr.I.I.2.5.2 deri II.7.4.2. )

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 22243423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>në veprimtari me natyrë ekspertize të kërkuara nga institucione të ndryshme në vend, ( personeli akademik pjesmarrëse në juri në Tiranë, Shkoder, Elbasan dhe Gjirokastër).<sup>42</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit, si pjesë e Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve ku ofrohet program i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, në përputhje me statusin që ka, konfirmojmë se ka organizuar një sërë aktivitetesh artistiko shkencore, që lidhen me realizimin e objektivave të syllbuseve të këtij programi si pjesmarrje në koncerte, festivale, konkurime, (si koncerte në Korçë, takimi orkestrave në Elbasan, etj. Rezulton se ky departament është pjesë integrale edhe e një sërë projektsh shkencore më partnerë evropianë në kuadrin e të cilëve ka organizuar dhe ka marrë pjesë në koncerte takime dhe konferenca shkencore.( Zyra e projekteve paraqiti dokumentacion të një sërë aktivitetesh organizuar nga institucioni në kuadrin e këtyre projekteve ).<sup>43</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Gjatë vizitës u konfirmua nga dokumentacioni I verifikuar, angazhimi e një numri studentësh në institucione artistike në vend gjatë viteve 2019-2022 ( 6 studentë punësuar në shkollat e mesme artistike; orkestrën e forcave të armatosura ) apo pjesmarrje në audicione për pozicione në orkestrat e të rinjve të krijuara në kuadër të nismave rajonale si CEMAN (Central European Music Academies Network,) gjë e cila tregon se në këtë program është punuar mirë për formimin e profesionistëve konkurrues për tregun e punës si brenda dhe jashtë vendit.<sup>44</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Duke analizuar strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” objektivat e tij për formim të studentëve si në aspektin artistik por edhe mësimdhënës mund të konkludojmë se Departamenti i Interpretimit përgjegjës për këtë program studimi ka marrë në konsideratë të gjitha sugjerimet nga MAS, (udhezimi nr.100 datë 25.02.2022) institucioneve të tjera, kërkesave të tregut të punës, lidhur me e studentëve të tyre me mundësinë për licensimin në profesionin e mësuesisë.<sup>45</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh.</p>	<p>Rezulton se program i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe udhëzimet e MAS për profesionet e rregulluara ku përfshihet edhe mësuesia si pjesë e formimit të studentëve të këtij programi (<b>Ligji Nr. 10. 171, date 22.10.2009 Për profesionet e rregulluara</b>),.</p>

<sup>42</sup> Foto personeli akademik i FM si juri konkurseshe e kornisione vlerësimi: Shkoder, Elbasan, Tirane, Gjirokaster. (Ref.nr.7.2.1.)

<sup>43</sup> Foto nga 60 vjetori I UART (Ref.nr. II.7.4.1.) ; Foto ne teater Korce dhe takim orkestrave ne Elbasan.( Ref.nr.7.4.2. dhe 7.4.3.)


<sup>44</sup> Foto nga koncerte CEMAN. (Ref.nr.7.4.1.)

<sup>45</sup> Rregullore per praktikat profesionale ne mesuesi Date 25.02.2022. (Ref.nr.7.6.4.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).									
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se Programi i studimit Maser i arteve në “Violinë dhe Mësuesi” bashkërendon veprimtaritë e tërë strukturave të saj për realizimin e objektivave të programit të studimit dhe veprimtarisë artistike dhe shkencore, me një pjesmarrje dinjitoze me partnerë ndërkombëtarë, me një angazhim të studentëve cilësor në këto veprimtari. Ajo ka zbatuar të gjitha aktet ligjore lidhur me kërkesat që lidhen për profesionin e rregulluar në fushën e mësuesisë. Standartet përmbushen plotësisht								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Rezulton se Universiteti i Arteve ka përcaktuar nepërmjet një sërë dokumentash të miratuara format e mësimdhënies me të cilat realizohet procesi mësimor. Këto forma të mësimdhënies janë të përcaktuara në <b>rregulloren e Fakultetit të Muzikës neni 34</b> Mësimdhënia; rregullore e studimit të programit Masteri Arteve në Violin dhe Mësuesi <b>neni 13;14</b> , si dhe në programet e lëndëve. Edhe praktika profesionale është organizuar dhe zbatuar, bazuar në <b>urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr.1305 datë 25.02 2022</b> për rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale, dhe <b>rregullore e studimit të programit Masteri Arteve në Violin dhe Mësuesi neni 28.</b>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke	Duke shqyrtuar dokumentacionin e departamentit që zbatohet për mësimdhënien, lidhur me programet e studimit të nivelit të dytë si dhe nga një analizë e syllabuseve të programit Master i Arteve në” Violinë

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>dhe Mësuesi”, mund të konstatojmë se personeli akademik që është përfshirë në realizimin e këtij programi përdor forma dhe metoda mësimdhënëse në përputhje me natyrën e programit dhe të mundësive të studentëve</p> <p>Për specifikën që ka institucioni format e mësimdhënies janë në përputhje me këtë specifikë si leksione speciale individuale, saxho, mësim ansambël në grup, ushtrime etj.</p> <p>Në një shqyrtim të syllabuseve rezultojnë se zbatohen edhe forma të tjera si punime individuale, esse dhe detyra, koncerte etj.<sup>46</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve.</p>	<p>Universiteti I Arteve dhe Fakulteti i Muzikës rezultojnë se mbështet pedagogët për kualifikimin e tyre si në aspektin artistik ashtu edhe didaktik duke krijuar mundësi si në shfrytëzimin e infrastrukturës së institucionit ashtu edhe në pjesëmarrjen e tyre në projektet e ERAZMUS + në veprimtari me karakter didaktik. Kjo e drejtë dhe detyrim i personelit për trainim dhe kualifikim është pasqyruar edhe në Statutin e UARIT nën 68 “ Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik”</p> <p>Një aspekt i rëndësishëm i përmirësimit të kompetencave didaktike është edhe pjesëmarrja në Master classe dhe koncerte të cilat rezultojnë se janë të shumta në këtë institucion.<sup>47</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe CV-ve të stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi rezultojnë se pedagogët që japin mësim në këtë program janë personalitete të njohura në fushën e artit me një eksperiencë shumëvjeçare si në aspektin artistik ashtu edhe në mësimdhënien. Për vitin akademik 2021-2022 nga 17 pedagog PAE të përfshirë në mësimdhënien në programin e studimit, 7 janë me titullin Profesor; 4 Prof. asociuar; 2 me titullin Doktor dhe 4 Asistent lektor, ndërsa staf PAK i këtij programi janë 3 pedagogë nga të cilët 2 me titull Doktor dhe 1 Asistent lektor.</p> <p>Po ashtu rezultojnë se edhe pedagogët që mbulojnë lëndët didaktike kanë kualifikim të duhur sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi.</p> <p>Nga analiza e syllabuseve kupton se stafi akademik përdor forma të larmishme mësimdhënies bashkëpunuese duke integruar studentët në procesin mësimor dhe ruajturi marrëdhëniet korrekte me to. Pjesëmarrja e studentëve së bashku me stafin në koncerte apo veprimtari artistike janë një pasqyrë e mirë e këtyre marrëdhënieve, dhe e zbatimit të kodit të etikës që funksionon në këtë institucion.<sup>48</sup></p>

<sup>46</sup> Syllabusët e Programit të Studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” (Ref.nr.III.1.2.3.)

<sup>47</sup> Foto nga masterclassët e profesorëve ndërkombëtarë në kuadër të Erasmus+ (Ref.nr.III.1.3.2.)

Faqja zyrtare UARIT <http://www.uart.edu.al> ( rubrika “Aktivitete”).


<sup>48</sup> CV e pedagogeve të sipas grupeve mesimore lëndore.(Ref.nr.1.1.16.); Syllabusët e programit (Ref.nr.III.1.2.3.)

<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Ne dokumentacionin e Fakultetit të Muzikës dhe në Departamentin e Interpretimit janë përcatuar detyrimet e pedagogëve për një mbarëvajtje të procesit mësimor (<b>neni 28. pika 14;16; 17; i rregullores se Departamentit të Muzikës</b> si dhe <b>neni 14 i rregullores së studimit të programit</b> ) ashtu edhe format dhe mënyrat e vlerësimit të mësimdhënies së stafit akademik në analizat vjetore dhe pyetsorët me studentë.</p> <p>Nga takimi me studentë rezulton se departamenti jo vetëm që ka përfshirë studentët në këtë proces, por edhe ka reflektuar ndaj sugjerimeve të tyre. Studentët e vitit të dytë të studimeve deklaruan se ka patur një rast të tillë kur është marrë në konsideratë sugjerimi i tyre për të ndryshuar në planin mësimor nga simestrale në shtrirje vjetore ngarkesën e lëndës Histori muzike dhe Histori e estetikës muzikore.<sup>49</sup></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Fakultetin e Muzikës dhe verifikimit gjatë vizitës në këtë fakultet rezulton se janë ngritur struktura apo njësi të cilat ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies, nepërmjet kordinimit të veprimtarisë së tyre si grupet mësimore, sekretaria mësimore dhe komisioni që është ngritur për sigurimi e cilësisë.</p> <p>Perdorimi i masterclasseve si forme shkembimi të eksperiencave mësimdhënëse, mes stafit akademik dhe pedagogëve të huaj të ftuar është një formë e rëndësishme që ndihmon në zhvillimin dhe përdorimin e metodave të reja inovative.</p> <p>Në takimin me drejtuesin e zyrës së projekteve u konstatua se pjesmarrja në projekte me universitete homologe jashtë vendit rezulton si një mundësi trainimi për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse.<sup>50</sup></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni ka sanksionuar me rregullore forma të larmishme mësimdhënie në përputhje me specifikën e tyre si institucion artistik, për një proces të nxëni dhe aftësim profesional e shkencor të studentëve, duke integruar dhe nxitur studentët në këtë proces. Standarti përmbushet plotësisht</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p><b>X</b></p>

<sup>49</sup> Takimi me studente (ref.Minuta takimi )

<sup>50</sup> Foto nga masterciasset dhe/ose koncertet e kolegëve nga institucionet partnere Erasmus+ K4107. (Ref.nr.III.1.3.2.); Faqja zyrtare UART <http://www.uart.edu.al>. ( rubrika "Projekte").

**Standardi III.2****Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në rregulloren e Departamentit të Interpretimit kreu V nenet 29;30;31;32 janë përcaktuar qartë mënyrat format dhe kriteret e vlerësimit të studentëve të të gjitha programeve të studimit. Mënyra e vlerësimit kriteret parakushtet për të hyrë në provim, sezonet e kontrollit të dijes janë të përcaktuara edhe në rregulloren e studimit të Masterit të Arteve në Violinë dhe Mësuesi neni 17;18;19;20;21 si dhe syllabuseve të programit.Këto rregullore janë të publikuara në faqen zyrtare të UART-së. Njohja e studentëve me rezultatet e vlerësimit të tyre bëhet nepërmjet sistemit të menaxhimit të vlerësimit të studentëve (ESSE3) aktualisht sistemi PITAGORA, përmes të cilit,jo vetëm dokumentohen testimet dhe vlerësimet e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve të program të studimit Master i Arteve ne “Violinë dhe Mësuesi” por edhe mundësohet komunikimi i drejtperdrejtë me studentet Violiniste lidhur me vendosjen e rezultateve në databazen e UART. <sup>51</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Mënyra e vlerësimit të studentëve sipas rregullores së UART neni 78 obligon pedagogët ta bëjnë prezent para studentëve në orën e parë të mësimit të gjitha format dhe kriteret e vlerësimit.Gjatë takimit me stafin akademik dhe me studentë u konfirmua se ato njihen me përmbajtjen e lëndës dhe me format e vlerësimit në orën e parë të mësimit. Në sekretarinë mësimore na u komunikua se po punohet për të digjitalizuar edhe syllabuset me qëllimin që studentët të kenë akses online dhe të njihen si me përmbajtjen e lëndëve por edhe me format e vlerësimit të tyre. <sup>52</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Duke ju referuar rregullores së studimit të Departamentit të Interpretimit si dhe rregullores së studimit të programit të studimit të nivelit të dytë neni 20; 21, rezulton se përdoren një tërësi formash testimi dhe vlerësimi, dhe ka një sistem vjetor vlerësimi.Rezulton nga studentët se vlerësimi i tyre është një sistem që përmban edhe vlerësimin e përformancës së tyre gjatë vitit dhe vlerësim të njohurive teorike.Këtë mënyrë vlerësimi u konstatua gjatë vizitës se behej edhe në mbrojtjen e diplomës, ku studenti përvec përformancës me

<sup>51</sup> Rregullore e Programit te studimit Cikilt le Dyte Master,(Ref.nr.III.2.1.1.); PITAGORA Manual perdorimi per studente dhe pedagoge. (Ref.nr.II.2.1.1.)

<sup>52</sup> Syllabysset e Planit Mesimor te Prograinit te studimit Master i Arteve ne” Violine dhe Mesuesi. (Ref.nr.III.2.2.2.) ; Rregullore e UART neni 78 ( Ref.nr.I.I.1.3.7.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	instrument, paraqiste edhe një mikrotezë, ku trajtohej teorikisht pjesa që ai luante me instrument. <sup>53</sup>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ është i mendimit se në realizimin e programit të studimit Master i Arteve në “Viole dhe Mësuesi” stafi akademik përdor konform rregulloret të miratuara forma të larmishme mësimdhënie dhe kontrolli në përputhje me specifikën e natyrën e institucionit .Rezultatet e arritura në aftësimin artistik të studentëve e konfirmojnë këtë gjë.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në rregulloren e Departamentit të Interpretimit kreu V dhe në rregulloren e studimit të Masterit të Arteve në Violinë dhe Mësuesi rezulton se janë përcaktuar qartë që vlerësimi përfundimtar reflekton rezultatin integral të të gjithë vitit sipas syllabusit të lëndës respektive dhe duhet të reflektohet në vlerësimin përfundimtar.. Periudha kohore e marrë në shqyrtim shtrihet në të gjithë vitin akademik dhe çdo lëndë ka mënyrën e vet specifike të vlerësimit dhe raporte të ndryshme të elementëve që janë fleta e provimit dhe procesverbali I vlerësimit. ( neni 21 I rregullores së studimit Master I Arteve ). Në takimin me studentë dhe stafin akademik të programit të studimit u konstatua se gjatë tërë vitit ngrihet një komision i cili verifikon format dhe mënyrat e vlerësimit të studentëve. Studentët deklaruan se vlerësimi i tyre shtrihet gjatë tërë vitit si për performancën e tyre në instrument por edhe më provime dhe kolegjiume në pjesën teorike të programit të lëndës. <sup>54</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nuk ka një sistem vlerësimi elektronik, pasi nuk është i volitshëm për specifikën e lendeve artistike. Për lëndët profesionale artistike vlerësimi bëhet me interpretim muzikor në kohë reale dhe me praninë e publikut, duke shmangur në këtë mënyrë ndonjë formë abuzimi dhe subjektivizmi në vlerësim. Për lëndët teorike u verifikua se përdoren sekretimi i fletës së provimit, që jep mundësi të ketë objektivitet në vlerësim, por mendojmë se në

<sup>53</sup> Rregulloreti Mesimore të Studimeve të Ciklit të Dytë neni 20 (Ref.nr.II.1.3.8.) Rregullore e programit Master i Arteve në Viole dhe Mesuesi neni 20; 31, (Ref.nr. 01.)

<sup>54</sup> Syllabuset e programit Viole dhe Mesuesi. (Ref.nr. III.3.1.1.); Rregullore e programit Master i Arteve në Viole dhe Mesuesi (Ref.nr. 01.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>kushtet e sotme duhet të aplikohet sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimit, sistem që sipas deklaramit të studentëve ishte përdorur gjatë pandemisë me platformat Moodle dhe Teams.<sup>55</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Duke shqyrtuar syllabuset rezulton se jo në të gjithë programet e lëndëve është përcaktuar qartë mënyra e vlerësimit të studentëve.</p> <p>U verifikua pranë sekretarisë mësimore (ku disponoheshin syllabuset) se syllabuset kishin të përcaktuar qartë mënyrat dhe format e vlerësimit, gjë e cila u konfirmua në takimin me studentë se njiheshin edhe nga ata. Por u konstatua se në 2 apo tre syllabese vlerësimi është ndarë në pjesmarrje e studentit gjatë vitit ose 20 % gjatë vitit dhe 40% provimi përfundimtarë, pa përcaktuar qartë se cilat do të jenë format e vlerësimit si edhe e parashikon rregullorja e studimit.<sup>56</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në takimin me studentë u verifikua se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet edhe me komente e diskutime të hapura përpara të gjithë grupit të studentëve dhe lidhet me këshilla të vlefshme nga artistet e afirmuar të personelin pedagogjik akademik mbi procesin e të nxënës dhe ndihmon për të projektuar punën në të ardhmen.</p> <p>Duke u nisur nga natyra e lëndëve dhe forma e vlerësimit që ka në themel performancën e studentit në instrument dhe që realizohet gjatë tërë vitit në orët e punës individuale me to, studentët deklaruan se feedbacku i pedagogut është gjithmonë i pranishëm dhe i ndihmon të përmirësohen në performancën e tyre me instrumentin.<sup>57</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në dokumentacionin që zotëron njësitë përgjegjëse e programit të studimit janë të përcaktuara qartë procedurat e realizimit të provimeve për të shmangur kopjimin apo plagjiaturat. Në provimet teorike zbatimi i elementëve të tillë si identifikimin e studentit nëpërmjet një dokumenti zyrtar (id, pasaportë et/), ndalimin e aparaturave të teknologjisë, të cilat nuk janë pjesë e zhvillimit të provimit (telefon, etj), ndalimin e pranisë së personave që nuk kanë lidhje me testimin, sekretimin e provimit me shkrim për të ruajtur anonimatën e studentit dhe vlerësimet subjektive të mundshme, janë pasqyruar në nenin 20 pika 8;9;10; të rregullores të studimit të ciklit të dytë Master I Arteve ne Violine dhe Mesuesi.</p> <p>Takimi cdo javë me pedagogun udhëheqës gjatë përgatitjes së diplomës deklarohet nga drejtuesit e njësive se është një formë e mirë për të shmangur plagjiaturën, por nuk rezulton se ka kontroll të plagjiaturës me platformën elektronike.<sup>58</sup></p>

<sup>55</sup> Fletë provimi vjetor lëndë individuale artistike dhe/ose në ansambel model. ( Ref.III.3.2.1.); Flete provimi dhe procedura e sekretimit (Ref.nr.III.3.2.2.)

<sup>56</sup> Vlerësim i praktikës artistike, model (Ref.nr. III.3.3.2.); Vlerësim i praktikës mesimore model (Ref.nr.III.3.3.3.)

<sup>57</sup> Takimi me studente gjatë vizites.( ref. Minuta takimi )

<sup>58</sup> Rregullore e programit Master I Arteve ne Violin dhe Mesuesi neni 20 ( ref.nr.01); Flete provimi vjetor lende individuale artistike dhe/ose ne ansambel, model (Ref.nr.III.3.4.1.); Kodi i Etikës (Ref.nr.III.3.5.1.)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga verifikimi i formave dhe procedurave të vlerësimit rezultojnë rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe realizohen mbi bazën e meritës sipas specifikimeve respektive të rregullores së studimeve dhe vlerësimit gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndës së syllabusit të programit mësimor. Për më tepër, ballafaqimi i vazhdueshëm me publikun dhe komisionet e audicioneve apo konkurseve të ndryshme, i bëjnë të paimentuar si studentin, ashtu edhe pedagogun që të vendosë rezultat të pabazuar në meritë.<sup>59</sup></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga rishikimi i dokumentacionit rezultojnë se në nenin 20 pika 13;14 të rregullores së studimit të ciklit të dytë Master I Arteve janë të pasqyruara të gjitha procedurat për njohjen e studentit me vlerësimin dhe garantohet e drejta e studentit për rastet kur ka kontestim të vlerësimit. Në takimin me studentë u konfirmua nga ata se nëpërmjet platformës Pitagora dhe me E-Mail marrin në kohë vlerësimin e anës teorike të provimit të kryer, si dhe i njihin mirë procedurat e rishikimit të vlerësimit, ankimit, ngritjen e një komisioni të ri vlerësimi, ndonjëse nuk kishte patur ndonjë rast të tillë.<sup>60</sup></p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p><b>Në nenin 20 pika 17 të rregullores së studimit të ciklit të dytë Master I Arteve janë të pasqyruara të gjitha procedurat për rastet kur ka ankimim lidhur me vlerësimin e studenteve.</b> Në këtë rregullore janë pasqyruar të gjitha të drejtat e Dekanit të Fakultetit për anulimin e vlerësimit të bërë dhe ngritjen e komisionit të ri të rivlerësimit të studentit. Nga vizita rezultoi se nuk ka patur asnjë kërkesë për ankimim nga ana e studentëve në këtë program.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ mendon se institucioni përdor formë dhe procedurë të vlefshme vlerësimi duke garantuar një vlerësim objektiv dhe në kohë nëpërmjet platformës Pitagora dhe performancës para publikut për lëndët artistike, por duhet të fillojë edhe kontrollin me sistemin elektronik dhe antiplagjiaturë të provimeve. Duhet thënë se në dy apo tre syllabuse ka vend për përmirësim në sistemin e vlerësimit të studentëve</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<b>X</b>	



<sup>59</sup> Faqja zyrtare e UART <http://www.uart.edu.al>. ( rubrika "Aktivitete").

<sup>60</sup> Rregullore e studimeve të programit Master i Arteve në Violinë dhe Mesuesi **neni 20.**( Ref.nr. III.3.7.1.);Manual studentit në sistemin Pitagora (Ref.nr.III.3.2.1.).

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

**Standardi III.4**

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Duke bërë një analizë të strukturës dhe përmbajtjes të dy planeve mësimore atij të nivelit bachelor dhe master i arteve rezulton se programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” jo vetëm që është një vazhdimësi logjike me programin bachlor në aspektin e realizimit të synimeve dhe objektivave të tij por edhe synon thellimin e mëtejshëm të njohurive dhe aftësimin e tyre profesional.Strukturimi i këtij programi jep mundësi studentëve që të zhvillojnë aftësitë profesionale dhe artistike në një qasje ndërdisiplinore por edhe krijimin e mundësive per tregun e punes edhe si specialist i artit dhe si mësues.<sup>61</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” rezulton se ka një lëndë (Informatike e aplikuar ) e cila ka si objektiv të saj zhvillimin e aftësive teknologjike në shërbim të profesionit të tyre.Si edhe konstatohet nga qëllimi i lëndës studenti aftësohet për realizimin e një projekti individual dhe të pavarur rregjistrimi,masterizimi dhe realizimi në CD audio të performancës së tyre solistike. Neni 11 pika 3, e rregullores së programit të studimit Master I Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” përcakton qartë që studenti që rregjistrohet në këtë program studimi duhet të zotërojë një nga 5 gjuhët e huaja të Bashkimit Europian gjë e cila zbatohet për këtë program.<sup>62</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i syllabuseve konstatohet se ka një feedback lidhur me rezultatet e arritura nga studentët sidomos në lëndët artistike, ku vihen në dukje sidomos mangësitë që shërbejnë për përmisimin e performancës në insrtument. Në disa lëndë u tha nga stafi akademik në takim për vetë natyrën e tyre ka 2 ose 3 titullarë që firmosin,ndaj cdo sugjerim që vjen nga studentët pasqyrohet në programin e lëndës.Kjo gjë u konfirmua edhe nga studentët në rastin e lëndës Histori e Muzikës dhe Histori e Estetikes muzikore.<sup>63</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe</p>	<p>Nga verifikimi I dokumentacionit të programit të studimit Master I Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” konfirmojmë se se ka një raport të tillë 917 orë në auditor dhe 2183 ore punë individuale që më natyrën ë programeve tregon se i jepet përparësi aftësimit artistik dhe profesional të studentëve, dhe krijimit të kompetencave, por dhe në lëndët kolektive</p>

<sup>61</sup>Plani mesimor Bachelor Violine. (Ref.nr.I.I.1.1.14.); Plani mesimor Master Violine dhe Mesuesi. (Ref.03.)


<sup>62</sup> Plani mesimor master Violine dhe Mesuesi. **Moduli C.** (Ref.nr.03.); Rregullore e studimeve te programit Master i Arteve ne Violine dhe Mesuesi **neni 11. Pika 3 .** ( Ref. nr. III.3.7.1.)

<sup>63</sup> Syllabyset e Planit mësimor Master “Violinë dhe Mësuesi”. (Ref.nr. III.4.3.1.) ; Takimi me studente dhe stafin gjate vizites ( **Minuta takimi** )

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>interpretative (Muzikë dhome, Ansambël apo Orkestër), të cilat arrijnë në kuotën 92 ECTS /120 ECTS</p> <p>Nga shqyrtimi I syllabuseve rezulton se ka një përqindje të madhe të karakterit praktik, apo zbatimit të metodave dhe aktivitetetve nga pedagogët në klasë, duke krijuar klimën e përshtatshme për pjesmarrje të studentëve dhe mbështetjen e ideve inovative.</p> <p>Rezulton se 2 studentë kanë realizuar mobilitete në universitete partnere jashtë si në Norvegji (Universiteti AGDER), Spanjë (Conservatorio Superior De Musica de Vigo ) dhe këtë vit kishin fituar edhe 2 studentë të tjerë.<sup>64</sup></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Për vetë natyrën e fakultetit si fakultet i muzikës , orët e hapura e seminarët për zhvillimet e reja të shkencës ( muzikës) rezulton se janë të lidhura me veprimtaritë e organizuara jashtë auditorit si koncerte apo evente koncertale etj. Me rastin e 60 vjetorit të UART u organizuar 60 ditë koncerte jashtë procesit mësimor.<sup>65</sup></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të fakultetit dhe me studentë rezulton se institucioni konsideron si ide inovative, evoluimin e gjuhës, mjeteve shprehëse të krijimtarisë dhe interpretimit bashkëkohor si dhe interpretimin e veprave të reja premiere të muzikës bashkëkohore, por nuk rezulton të ketë mbështetje direkte financiare. Ato mbështeten me dhënien e te drejtës për të përdorur sallat për koncerte apo veprimtari si dhe për logjistikën e veprimtarive.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se përfshirja e studentëve në veprimtarinë artistike (koncerte apo evente koncertale) mobilitetet e tyre të realizuara në universitete homologe jashtë vendit janë një aspekt i rëndësishëm që garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbylljes së standardit</b></p>	<p>Përmbylljet pjesërisht</p>	<p>Përmbylljet kryesisht</p>	<p>Përmbylljet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b> Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre</p>	<p>Në rregulloren e studimit Master I Arteve në Violinë dhe Mësuesi rezulton se në nenin 30 të saj dhe në rregulloren e studimit të programit Master në Violinë dhe Mësuesi nenet 29;30;31;32, janë të përcaktuara</p>

<sup>64</sup> Syllabuset e Planit mësimor Master "Violinë dhe Mësuesi". (Ref.nr. III.4.4.1.); Mobilitet ne kuadrin e projektit ERAZMUS + (Ref.nr. I.I.3.3.3.)

<sup>65</sup> Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> ( rubrika "Aktivitete per 60 vjetorin").

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	të gjitha procedurat lidhur me detyrimet përmbyllëse, si dhe dhënies së diplomës. Këto rregullore janë të publikuara në faqën zyrtare të UART-së. <sup>66</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Nga shqyrtimi I dokumentacionit të institucionit UART të rregulloreve të studimit, konfirmohet se janë të përcaktuara qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tërë strukturave si akademike dhe administrative për të mbështetur studentët me informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme që lidhen me detyrimet mbyllëse apo diplomimin. Në planin mësimor të programit është planifikuar në semestrin e fundit edhe një takim i përjavshëm 2 orësh në auditor për të ndjekur ecurinë e punës së studentit dhe për ta ndihmuar atë, gjë e cila u konfirmua edhe nga studentët gjatë takimit. Po kështu rezulton se në faqen zyrtare të UART-së në rubrikën “Trasparenca” tek procedura informimi dhe ankimim, studenti mund të marrë informacion apo të bëjë kërkesë për të marrë çfarë i nevojitet. <sup>67</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<b>Ne rregulloren e programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” në nenin 30;31; dhe 32,</b> publikuar në faqen zyrtare të universitetit, rezulton se janë të pasqyruara tërë procedurat e punimit dhe të mbrojtjes së diplomës para një komisioni I cili përbëhet nga pedagog me tituj nga departamenti dhe që bëhet publikisht. Edhe nga <b>deklarimet e studentëve konfirmohet se diplomimi përmban interpretimin e një pjese muzikore dhe mikrotezën një studim lidhur me pjesën që ka interpretuar.</b> Drejtuesit e fakultetit dhe studentët deklaruan se komisioni i ngritur për diplomimin merr në konsideratë tërë ecurinë dhe rezultatet e tyre gjatë dy viteve. Kjo gjë u dokumentua edhe me verifikimin e procesverbalit të provimit të diplomimit pranë sekretarisë mësimore.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse	Në rregulloren e studimit të programit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” në nenin 31 janë të përcaktuara qartë detyrat e udhëheqësit të diplomës për studentët, grafikun e konsultimeve, afatet e realizimit të punimit, dhe garancinë për cilësinë e punimit. Konstatohet në planin mësimor në semestrin e katërt janë dy orë në javë në auditor që udhëheqësi i përdorte për të kontrolluar ecurinë e punës të studentit dhe për të dhënë udhëzime për përmisim. Në rregullore është përcaktuar edhe detyrimi i njësisë bazë për të kontrolluar ecurinë e kësaj pune. Departamenti disponon dokumente ku mund të verifikohen këto kontrolle periodike që ka bërë kjo njësi. <sup>68</sup>

<sup>66</sup>Rregulloren e studimit të programit Master në Violinë dhe Mësuesi **nenet 29;30;31;32,**( Ref.nr.01)

<sup>67</sup> Plani mesimor Master I Arteve Violinë dhe Mësuesi. (Ref.nr.03); Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> rubrika “Trasparenca (informim dhe ankimim)”.; Formular rregjistrimi në provimin përmbyllës. (Ref.nr.5.2.1.)

<sup>68</sup> Formular mbrojtje diplome. (Ref.nr. III.5.2.1.); Rregulloren e studimit të programit Master në Violinë dhe Mësuesi neni 31( Ref.nr.01).

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.							
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Për vetë natyrën e institucionit ky kriter nuk zbatohet.						
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në rregulloren e studimeve të programit Master i Arteve në "Violinë dhe Mësuesi" në nenin 33 vlerësimi i punimit të diplomës jepen procedurat e vlerësimit të studentit në punimin e diplomës i ngritur dhe miratuar nga Dekani i Fakultetit. Rezulton se vlerësimi bëhet me pikë nga secili anëtarë i komisionit dhe mesatarizimin e pikëve e ben kryetari i komisionit, duke bërë edhe konvertimin e tyre në notë.						
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Rezulton nga dokumentacioni i verifikuar në sekretarinë mesimore se studenti pajiset pas përfundimit të detyrimeve mbyllëse me diplomë dhe suplementin e saj. Nga verifikimi i diplomës rezulton se diploma ka të gjitha elementët e përcaktuar nga MAS dhe rregullorja e studimit e njësisë kryesore. <sup>69</sup>						
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mesimore rezulton se në përputhje me ligjin Nr 9887, date 10.03.2008, për mbrojtjen e të dhënave personale , kjo njësi ndihmëse administrative ka dhe ruan për cdo student dokumentacionin përkatës që nga rregjistrimi dhe deri në diplomimin e tij, duke e vënë në dispozicion të tyre sa herë I kërkohet. <sup>70</sup>						
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se institucioni zbaton procedure të qarta lidhur me detyrimet permbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit ate me dokumentacionin e nevojshëm.						
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyshet pjesërisht</th> <th>Përmbyshet kryesisht</th> <th>Përmbyshet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht			X
Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht					
		X					

### Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<sup>69</sup> Procesverbal mbrojtje diplome ( Ref.nr.III.3.2.1.); Model diplome ( ref.nr.III.5.7.1.)

<sup>70</sup> Vizita ne institucion ( sekretaria mesimore ); Rregjister i arritjeve akademike (Ref.nr. V.4.3.2.); Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> . ( rubrika Politika e privatesise)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” është master shkencor, por duke patur praktikë artistike dhe profesionale (parashikuar në Planin mësimor), konfirmohet nga vizita në institucion se zbatohen të gjitha procedurat dhe krijohen të gjitha kushtet si me ambiente ashtu edhe me logjistikë për realizimin e tyre.		
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Është master shkencor ndaj ky kriter nuk zbatohet.		
<b>Kriteri 3.</b> Praktikatat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Për vetë natyrën e këtij masteri “ Violinë dhe Mësuesi” ka të planifikuar praktikën për mësimdhënie e cila realizohet në tre javë në shkollë, dhe është vlerësuar me 6 ECTS		
<b>Konkluzione</b>	<i>Në këtë institucion ky standart zbatohet pjesërisht pasi është Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
<b>Kriteret</b>	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga verifikimet e bëra në Departamentin e Interpretimit lidhur me stafin akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme rezulton se ky staf akademik është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, si dhe udhëzimet e MAS e rregulloreve të institucionit UART. Për vitin akademik 2020-2021 nga numri 17 total I pedagogëve me kohë të plotë që japin mësim në programin e studimit Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi ,7 janë me titullin shkencor “Profesor”, 4 janë me titullin “ Profesor I asociuar, 2 me gradën shkencore “Doktor” dhe 4 asistent lektor.</p> <p>Numri totali pedagogëve me kohë të pjesshme është 3 nga të cilët 1 Profesor dhe 2 me gradën Doktor</p> <p>Rezulton nga shqyrtimi i syllabuseve se të gjithë titullarët e lëndëve janë në përputhje me udhëzimet e MAS-së me tituj dhe grada shkencore.<sup>71</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Rezulton se personeli akademik efektiv i cili mbulon programin e studimit Masteri Arteve në Violinë dhe Mësuesi është në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, date 10.09.2018 Për Veprimtarin dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë dhe rregullores së studimit të këtij programi.</p> <p>Rezulton se stafi akademik PAE mbulon mbi 80% të ngarkesës mësimore të këtij programi studimi.<sup>72</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga analiza e planeve mësimore në tre vite si dhe nga një shqyrtim i dokumentacionit lidhur me pedagogët që japin mësim në programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” konstatohet se stafi akademik që mbulon ngarkesën e këtij programi sipas lëndëve është i pandryshueshëm dhe i janë likuiduar detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Nga verifikimi i stafit në tre vite rezulton se ka një ose dy pedagogë që nuk janë pjesë e stafit që mbulon këtë program studimi, por gjatë vizitës në institucion u konfirmua se kjo gjë lidhej me lëndën Ansambel alternativ që duke ndryshuar përbërjen e veglave pjesmarrëse në këtë ansambel ndryshojnë edhe pedagogët. Numri i pedagogëve të cilët kanë qënë pjesë e stafit PAK aktualisht sot është ulur. Raporti mes stafit PAE/PAK për vitin 2021-22 është 18/2 krahasuar me vitin 2020-21 ky raport është 19/7 dhe për vitin akademik 2019-2020 15/6 (tabela nr.7, në evidencën Tabele përmbledhëse për programin e studimit Master I Arteve Violinë dhe mësuesi)<sup>73</sup></p>

<sup>71</sup> VKM.Nr. 329, date 12.04.2017, Per statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik. (Ref.nr.IV.1.1.3.); VKM Nr. 145, date 10.03.2021 Per dhenien e statusit të veçantë të UART.(Ref.nr.IV.1.1.4.); Tabelat e stafit akademik për vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022. (Ref.nr. IV.1.1.8.)


<sup>72</sup> Udhëzim Nr. 29, date 10.09.2018 “Per veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik të IAL. (Ref.nr.IV.1.1.2.)

<sup>73</sup> Kopje e një modeli marrëveshje për kohën e punës vjetore të personelit akademik (Ref.nr. IV.1.3.1); Model draft kontrate të stafit akademik me kohë të pjesshme. (Ref.nr. IV.1.3.2.); Tabele përmbledhëse e aneksit të RVB-se (Ref.nr.IV.1.1.8.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në statutin e UART neni 70 dhe në rregulloren e studimeve neni 93 dhe 94, rezulton se janë të përcaktuara kriteret e përgjithshme dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe atij më kohë të pjesshme. Departamenti mund të vendosë kritere specifike në përshtatje me kërkesat që ka për pedagogun që do të rekrutojë.</p> <p>Në takimin me njësinë e Burimeve njerëzore u konstatua se në rekrutimin e stafit të ri ndiqen të gjitha procedurat e përcaktuara në rregullore, duke filluar nga përcaktimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike, shpallja në APP, ngritja e komisionit të vlerësimit, shqyrtimi i dosjes dhe intervista, të gjitha transparente publikuar në faqen zyrtare.<sup>74</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe infrastrukturës të departamentit të Interpretimit rezulton se në Statutin e UART-së dhe rregulloren e Departamenti të Interpretimit janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik ndihmës që kontribuojnë në procesin e mësimdhënies. Nga vizita dhe takimi me njësinë e Burimeve njerëzore konfirmuam se janë 7 punonjës të cilët janë përzgjedhur dhe janë të diplomuar sipas profilit të institucionit.<sup>75</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Konfirmojmë që ekziston një bazë të dhënash të detajuara për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit. Në zyrën e burimeve njerëzore ka një informacion të plotë të këtij stafi.</p> <p>Konfirmojmë se IAL disponon listën e plotë të personelit akademik që jep mësim në Programin Master i arteve në “Violinë dhe Mësuesi”. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Departamenti i Interpretimit, Sekretaria Mësimore kanë informacion të plotë për personelin e angazhuar në realizimin e programit dhe periudhën kohore të realizimit të detyrave përkatëse. Konfirmojmë se institucioni publikon kriteret për procedurat e rekrutimit të stafit dhe ndjek ato me korrektesë.<sup>76</sup></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të</p>	<p>Rezultun se institucioni ka marrëveshje që ka lidhur me ZVA-të e qyteteve Tiranë Elbasan dhe Vlorë nga edhe janë studentet e këtij programi studimi për realizimin e praktikën për mësimdhënien dhe praktikën artistike me institucione artistike kryesisht në Tiranë.</p>

<sup>74</sup> Model dosje për rekrutim personeli akademik. (Ref.IV.1.4.1.); Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> ( **Njoftime punesim** )


<sup>75</sup> Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë. (Ref.nr.IV.1.5.1.); Statuti UART neni 70, (Ref.nr. I.I.1.2.1.)

<sup>76</sup> Tabele e personelit për programin e studimit ( Ref.nr.I.I.2.1.3.); Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> ( rubrika stafi akademik )

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Për këto praktika rezultojnë se Departamenti i Muzikës ka perzgjedhur pedagogët më të mirë dhe me përvojë të cilët ndjekin studentin gjatë praktikës por edhe bëjnë vlerësimin përfundimtar sipas formatit që ka institucioni. Për detyrimet përmblyëse është studenti që perzgjedh udhëheqësin e tij gjithmonë sipas mundësive që pedagogët kanë, lidhur me ngarkesën e tyre. <sup>77</sup>		
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Nga dokumentacioni i paraqitur gjatë vizitës konfirmojmë se Fakulteti i Muzikës në marrëveshjen e lidhur me institucionet pritëse për praktikën mësimore dhe artistike ka përcaktuar qartë detyrimet e personelit mbikëqyrës lidhur me studentët, gjatë kohës së praktikës si dhe me plotësimin e raportit përfundimtarë dhe formularit të vlerësimit që i dërgohet.		
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se Fakulteti I Muzikës që mbulon këtë program studimi ka personel akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë, i cili përmbush standardet ligjore dhe akademike në përputhje me fushën e programit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në UART konstatojmë se në dispozicion të programit të studimit Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi, për vetë natyrën e vecantë të tij punën individuale të studentit me instrument dhe lëndët teorike, ka ambiente të mjaftueshme dhe cilësore për mbulimin e lëndëve të parashikuara në program. Janë 4 klasa për studim individual, 3 klasa për punën me grupe dhe 2 lektoriume për lëndët e natyrës specifike (lektoriumi T.harapi dhe C.Zadeja) të paisura edhe me instrumentat e nevojshëm për zhvillimin e mësimi. <sup>78</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së	Në ambientet e mësimi si në klasa ashtu edhe në lektoriume, (konstatuar gjatë vizitës) janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit specifike për natyrën e lëndëve të këtij programi si dhe mjete elektronike


<sup>77</sup> Marrëveshje për zhvillimin e praktikës mesimore profesionale me ZVA Vlore. ( Ref.nr.I.I.3.3.2.)

<sup>78</sup> Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> ( rubrika Ambientet )

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	(amplifikim audio, video projeksion, internet me kabëll, lidhje e laptopeve me HDMI apo VGA, dhomë regjie) Po kështu edhe në ambientet ku zhvillohen lëndët e karakterit teorik ka edhe internet me të cilat bëjnë të mundur realizimin cilësor të procesit mësimor. <sup>79</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atëlietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga verifikimi ambienteve të mësimin rezulton se në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit Master i Arteve në “Violinë Mësuesi” si dhe për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik, ka një sasi të mjaftueshme të instrumentave dhe aparaturave të nevojshme për realizimin e mësimin si Piano, insonorizim, lexhio, karrige, ngrohje, ndriqim ,internet etj.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Rezulton se UART dhe Departamenti I Interpretimit si pjesë e saj ka akses në një tërësi laboratorësh të instaluar pranë bibliotekës së këtij institucioni. Në laboratorin 1 ndodhen 5 kompjutera të pajisur me programin Sibelius (për notizimin sipas natyrës së programit digjital) dhe Steinberg Cubase (për regjistrim dhe përpunim audio), ndërkohe që në Laboratorin e Tingullit (studio e muzikës elektroakustike) është mundësuar implementimi i një studioje të mirëfilltë regjistrimi dhe përpunimi audio. <sup>80</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.	Rezulton se UART ka vënë në dispozicion të këtij programi studimi për të realizuar praktikën artistike jo vetëm ambientet e saj por edhe të institucioneve të tjera (nëpërmjet marrëveshjeve me to si TKOB apo edhe pjesëmarrje në koncerte që organizohen në institucionet artistike) Për realizimin e praktikës profesionale lidhur me mësuesinë rezulton se ka një program të caktuar lidhur me praktiken është një pedagog që është drejtues i saj dhe janë nënshkruar marrëveshje me ZAV- të ku studentët do të bëjnë praktikën.. <sup>81</sup>
<b>Konkluzione</b>	GVJ arrin në konkluzionin se institucioni ka mjaftueshëm mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit

<sup>79</sup> Vizita në ambientet e institucionit; Foto klasash, foto të lektoriumit dhe sallave të tjera të FM. ( Ref.nr.IV.2.2.1)

<sup>80</sup> Vizita në bibliotekën e UART; Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> ( rubrika Biblioteka )

<sup>81</sup>Model vleresimi i praktikës profesionale. (Ref.nr.IV.2.5.2.); Programi dhe rregullore e praktikës ( Dokumenta dorezuar pas vizites në Ascal )

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)






	mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit..		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Duke shqyrtuar përmbajtjen e syllabuseve të programit të studimit Master I Arteve në Violinë dhe Mësuesi konstatojmë se ne formatin e tyre është paraqitur literatura e domosdoshme për realizimin e objektivave të parashikuara në drejtim të thellimit të njohurive, por në disa syllabuse jo e ndarë si literature bazë dhe ndihmëse. Për formimin artistik ka një literaturë të mjaftueshme të përgatitur nga institucioni si partitura, pjesë muzikore nga kompozitorët mëdhej etj. por është vënë në dispozicion të studentëve edhe biblioteka online e cila në faqen zyrtare korespondon me “Katalogun online” dhe “Arkiven digjitale”. Për formimin profesional të mësuesisë është e njëjta pamje, por mund të konstatojmë se literatura duhet përditësuar në disa raste <sup>82</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe gjatë vizitës në bibliotekë u konfirmua se literatura në dispozicion të këtij programi është përditësuar sidomos në atë artistike me përditësimet respektive në katalogun online të BSHUA lidhur me partet dhe partiturat e Edicionit Henle Verlag,
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga verifikimi gjatë vizitës në ambientet e Bibliotekës së UART-së rezulton se studentët kanë në dispozicion bibliotekën mësimore duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit përmes teksteve të ndryshme, linqeve, librave online etj., në fushën artistike dhe të edukimit. Studentët kanë akses në Katalogun online dhe Arkivën digjitale që ka shtuar larminë e burimeve për materiale e literaturë në fusha të ndryshme të studimit. <sup>83</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e	Konstatohet se BSHUA ofron për studentët literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo faqe online dhe libra online, e nevojshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore si ato artistike por edhe në fushën e edukimit.

<sup>82</sup> Vizita në bibliotekën e UART; Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> ( rubrika Biblioteka Katalogu online dhe Arkiva digjitale )

<sup>83</sup> Katalogu online dhe Arkiva digjitale në rubriken Biblioteka në faqen zyrtare. ( <http://www.uart.edu.al> )

<p>përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në ambientet e BSHUA-së konstatohet se studentët kanë akses të barabartë për studentët në bibliotekë nëpërmjet faqes së Bibliotekës së Universitetit e cila ofron arkivë të digjitalizuar ku mund të gjendet informacioni i përgjithshëm, si dhe duke ofruar 2 burime informacioni pa pagesë për studentet e FM: njëra Biblioteka online specifike për programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” IMSLP - PETRUCCI MUSIC LIBRARY dhe Arkiva digjitale e BSHUA aksesueshme pas regjistrimit të studentit online.<sup>84</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita në ambientet e BSHUA rezulton se ka jo vetëm ambiente fizike të mjaftueshme, por edhe është mirë e paisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera në shërbim të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BSHUA-së në mënyrë të vecantë të rregullores se saj dhe në faqen zyrtare të institucionit rezulton se biblioteka qëndron e hapur çdo ditë nga ora 8.00 deri 19.00, dhe është në përputhje edhe oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Rezulton se në kohë provimesh ka një orar më të zgjatur në shërbim të studentëve. Me kërkesën e studentëve aty ofrohet shërbim në çdo kohë që kërkohet.<sup>85</sup></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga dokumentacioni zyrtar i shqyrtuar rezulton se, përmes komunikimeve zyrtare të njësisë bazë dhe kryesore me bibliotekën ndiqet dhe raportohet për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, zbatimin e orareve etj..<sup>86</sup></p>

<sup>84</sup> Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> ( rubrika Biblioteka Katalogu online dhe Arkiva digjitale )

<sup>85</sup> Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al> ( rubrika Biblioteka shërbime )

<sup>86</sup> Katalogu i veprave të fondit fizik dhuruar nga Henle- Verlag. (Ref.nr. IV.3.8.1.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<b>Konkluzione</b>	GVJ gjykon se njësia kryesore që mbulon programin e studimit Departamenti i Interpretimit, ka vënë në dispozicion të këtij programi tërë infrastrukturën e nevojshme si fizike ashtu edhe literaturën e nevojshme të përdituar në shërbim të procesit të mësimit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Konfirmojmë se UART disponon një sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Ky sistem përfshin sekretariatë mësimore, programi ESSE 3 dhe PITAGORA, sektori i statistikës dhe sektori i IT që ofron një sasi aplikacionesh të integruara me njëra tjetrën e cila jep mbështetje të plotë për procedurat e administrimit të mësimdhënies dhe vetëshërbimit nga ana e studentëve <sup>87</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga shqyrtimi I dokumentacionit pranë Njesisë të Burimeve Njerëzore Informacion Protokoll dhe Arkivë, Sekretarive mësimore si dhe Sektorit të Statistikës dhe IT-së, rezultojnë se administrohet tërë dokumentacioni që lidhet me përditesimin e të dhënave të stafit akademik ndihmës akademik dhe administrativ lidhur me tërë veprimtarinë e tyre në kuadrin e realizimit të programit të studimit Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi. <sup>88</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nga analiza e dokumentacionit të sistemit të menaxhimit rezultojnë se të dhëna lidhur me dokumentacion janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të UART dhe të njësive përkatëse. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të Universitetit të Arteve dhe Fakultetit të Muzikes, ku ofrohet programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”,

<sup>87</sup> Manual studenti në sistemin Pitagora .( Ref.nr.III.3.2.1.);Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al>. (rubrika njoftime për studente, Drejtorja e burimeve njerëzore dhe informacion/protokoll/arkive); Rregullore e funksionimit të sekretarive mesimore. Pdf; F

<sup>88</sup> Një model dosje të aktivitetit ndihmes akademik me kcsrakter mësimor, artistik dhe shkencor.(Ref.nr.IV.4.2.2.); Një model dosje të aktivitetit ndihmës akademik me karakter administrativ.(Ref.nr. IV.4.2.3.); Statuti i UART.( neni 75 deri 78) Ref.nr.I.I.1.2.1.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	siguron të akses të informacioneve dhe e dokumentave. Sekretaria mësimore vë në dispozicion të studentëve si planin mësimor, syllabeset, të dhëna të tjera kur kërkohen kopje fizike e tyre. <sup>89</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm të Universitetit të Arteve dhe Fakultetit të Muzikës, ku ofrohet programi i studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studenteve si sistemin e notave Sistemi PITAGORA si një platformë që siguron shkëmbim informacioni në kohë reale, midis personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit Platformia TEAMS mundëson forma e module të komunikimit interaktiv dhe të shkëmbimit të informacionit: si krijime të grupeve TEAMS, Whats AAp të krijuar nga studentët etj. <sup>90</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga verifikimi i dokumentacionit që disponon institucioni në tërësi dhe Departamenti i Interpretimit rezulton se sistemi i menaxhimit nëpërmjet një tërësi hallkash si listë prezence e pedagogëve, evidenca të ndryshme që plotësohen nga pedagogët, analizave të vazhdueshme që bëhen për veprimtarinë mësimore, komunikimit online, sekretarisë mësimore dhe platformave digjitalizuara mundëson një raportim permanent për organet drejtuese. <sup>91</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga verifikimi në Faqen zyrtare të UART-së mund të konfirmojmë se institucioni publikon vazhdimisht informacione për të gjitha fushat e funksionimit në Universitetit dhe në këtë kuadër edhe të informacionit që lidhet me programin e studimit Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi. Në këtë faqe zyrtare ka të dhëna për pedagogët, studentët, urdhera dhe udhëzime, veprimtari si dhe informacion që lidhet me programin e studimit në dy gjuhë shqip dhe në Anglisht. <sup>92</sup>
<b>Konkluzione</b>	GVJ arrin në përfundimin se institucioni UART dhe Fakulteti i Muzikës që mbulon këtë program studimi, ka një sistem menaxhimi institucional të aksesueshëm për të gjithë publikuar në faqen zyrtare të dhe njëherësh në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit..

<sup>89</sup> Model shkëmbimi të emailave të postës me sekretarinë mësimore dhe specialistes se sistemit Pitagora (Ref.nr. IV.4.3.1.); Model shkëmbimi të emailave të postës me Sektorin e IT. (Ref. IV.4.32.); Sistemi Pitagora për studente dhe staf akademik. (Ref. nr. III.2.1.1.).

<sup>90</sup> Model flete provimi gjeneruar nga PITAGORA. (ref. nr. IV.4.4.1.); Model Statistike pldorimi të platformes TEAMS për leksion online. (Ref. nr. IV.4.4.3.)

<sup>91</sup> Model listë prezence. (Ref. nr. IV.4.5.1.); Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al>. ( Drejtoria e burimeve njerezore dhe informacion/protokoll/arkive);

<sup>92</sup> Faqja zyrtare <http://www.uart.edu.al>.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga takimi me drejtuesin e Departamentit, stafin akademik dhe Degen e financës konfirmohet se ka një raport financiar që përgatitet nga njësia bazë lidhur me kostot financiare për mbulimin e programit të studimit Master i Arteve në "Violinë dhe Mësuesi" i cili përfshin shpenzime që lidhen me personelin akademik dhe ndihmës, përmisimin e infrastrukturës dhe kërkimin shkencor. <sup>93</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Rezulton nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga vizita në institucion se njësia bazë paraqet para degës së financës cdo vit kërkesat për mbulimin e shpenzimeve për programin e studimit, kërkesë mbi të cilën hartohet edhe plani financiar që miratohet nga Senati akademik, dhe Bordi i Administrimit. Nga shqyrtimi i buxhetit të institucionit konstatohet se është planifikuar sipas zerave të caktuar në buxhet, mbulimi i kostove për personelin PAE dhe PAK, mirëmbajtje e mjediseve dhe blerje të veglave muzikore, si dhe shpenzime për bibliotekën online. <sup>94</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Duke pasur parasysh specifikën e institucionit dhe kushtet e ngritjes së njësisë së auditimit të brendshëm në Sektorin publik, sipas parashikimeve të VKM nr 83, date 03.02.2016, UART nuk ka njësi auditimi pasi nuk i plotëson kushtet e parashikuara me ligj dhe nuk është

<sup>93</sup> Model Raporti financiar të kostove. (ref.nr.IV.5.1.2.)

<sup>94</sup> Vendim SA per Plan Buxhetin e financimit te Programeve të studimit.(Ref.nr.IV.5.2.1.); Vendim BA per Plan Buxhetin e financimit te Programeve te studimit.(Ref.nr. IV.5.2.2.)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	bërë ndonjë auditim. Audimi është bërë nga Auditi i MAS ne vitin 2014 dhe është bërë publik në faqen zyrtare të institucionit <sup>95</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Konfirmojmë se UART bazuar në Udhëzimin Nr. 5, date 19.02.2018 “Per përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” paraqet pranë Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit cdo vit sipas afatit të përcaktuar, raportin për realizimin e buxhetit të vitit sipas zërave përkatës ku përfshihen edhe shpenzimet për mbulimin e programeve të studimit. Ky rapor i dergohet edhe MAS dhe i bëhet i njohur tërë njësive të institucionit. <sup>96</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Drejtorinë ekonomike dhe takimi me drejtues të institucionit konfirmojmë se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë Departamentit të Interpretimit dhe ka kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, bazuar në grandin që vjen nga buxheti i shteti, të ardhurat që realizohen nga shërbimet që kryen si dhe të ardhurat që vinë nga projektet. <sup>97</sup>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ lidhur me standartin konkludon se Institucioni (UART dhe Fakulteti i Muzikës) nëpërmjet planifikimit dhe realizimit të buxhetit të tij garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<sup>95</sup> VKM nr 83, date 03.02.2016; Faqja zyrtare e UART. <http://www.uart.edu.al>. ( rubrika **Transparenca, mekanizma monitorues, Raport auditimi**)


<sup>96</sup> Udhëzimin Nr. 5, date 19.02.2018 “Per përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”; Nje model raportimi vjetor te UART. (Ref.nr.IV.5.4.2.)

<sup>97</sup> Model Raporti financiar te kostove te FM. (Ref.nr.IV.5.5.1.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga verifikimi I dokumentacionit që zotëron UART dhe Departamenti i Interpretimit rezulton se janë zbatuar konform legjislacionit në fuqi dhe akteve të saja rregullatore një sërë procedurash që lidhen me mbulimin e studentëve nga rregjistrimi e deri në përfundim të studimeve. Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe nga takimi me studentë, rezulton se studentët njihen që fillim me kriteret e pranimi dhe të konkurimit nepërmjet publikimit në faqen zyrtare nga ana e institucionit, me planin mësimor dhe kërkesat e programeve të lëndëve, mënyrën e komunikimit dhe të ankimimit, përparimit të tyre etj. <sup>98</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin eksistues të UART-së si dhe në faqen zyrtare të institucionit konfirmojmë se Statuti, Rregullorja e studimeve të nivelit të dytë si dhe Rregullorja e pranimi dhe e studimit e Programit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, mundësojnë dhe garantojnë barazitë njëjta për të gjithë studentët e këtij programi. <sup>99</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Nga analiza e rregullores së konkursit të pranimi për vitin akademik 2022-2023 të hartuar nga Fakulteti i Muzikës dhe miratuar nga Senati me Vendim Nr 11 datë 08.02.2022, konfirmohet se kriteret e veçanta të pranimi të studentëve për Programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” janë hartuar në bashkëpunim me tërë strukturat e këtij institucioni duke zbatuar udhëzimet e MAS.
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë	Rezultoni se UART ka miratuar dhe i ka të aksesueshme pranë sekretarive mësimore në formë shkresore dhe elektronike, rregulloret e studimit të ciklit të dytë, rregulloren e pranimi dhe konkurimit, të cilat bëjnë të mundur njohjen nga të gjithë studentë dhe të interesuar të kriterëve dhe procedurave të pranimi në programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, si dhe informacion për njohjen dhe

<sup>98</sup> Statuti i UART. Neni 92.93.94 (Ref.nr. I.I.1.2.1.); Rregullore e studimit te Programit Master i arteve ne Violine dhe Mesuesi. neni 7 deri 13 dhe 29 deri 31 (Ref.nr.II.3.1.2.)

<sup>99</sup> Rregullorja e studimeve të nivelit të dytë (Ref.nr. I.I.1.3.8.); Rregullorja e pranimi dhe e studimit e Programit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”, (Ref.nr.II.1.6.4.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	mënyrat e vlerësimit, transferimit apo ekuivalentimit të studimeve të mëparshme. Nepërmjet Platformës Pitagora studentët njihen online për përparimin e tyre në kohë reale. <sup>100</sup>		
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Në faqen zyrtarë të UART në rubrikën studentët rezultojnë se janë të publikuara rregullorja e konkursit të pranimit si dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi të aksesueshme për çdo konkurent apo më gjërë. <sup>101</sup>		
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar konkludojmë se institucioni ka të përcaktuar dhe të miratuar kuota pranimit të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të kufizuara, nga trojet shqiptare si dhe shtresat e marginalizuara, <sup>102</sup>		
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në rregulloren e konkursit dhe të pranimit të programeve të studimit nivelit të dytë Master <b>neni 2 pika 2.1</b> konfirmohet se në konkurim mund të marrin pjesë të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor, dhe për studentët jashtë vendit pas ekuivalentimit të diplomës.		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Nga verifikimi i bërë në faqen zyrtare të UART rezultojnë se në rubrikat e faqes zyrtare të Departamentit të Interpretimit publikohen të dhëna për kriteret dhe mënyrën e aplikimit nga studentët për përfitim për bursa studimi si dhe për përjashtimin nga tarifa shkollore për ti ardhur në ndihmë studentëve që vinë nga shtresat në nevojë. Në takimin me studentë dhe në sekretarinë mësimore u konfirmua ky fakt. <sup>103</sup>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ bazuar në dokumentacionin dhe vizitën në institucion mendon se UART ka një sistem dhe procedura transparente të pranimit dhe mbështetjes se studentëve dhe i aksesueshëm nga të gjithë në publikimet në faqen zyrtare të tij. .		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përm. ushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<sup>100</sup> Rregullore dhe kriteret pranimit cikli I dytë Master (Ref.nr.II.1.6.4.); Platforma PITAGORA (ref.nr. III.2.1.1.)

<sup>101</sup> Faqja zyrtare UART <http://www.uart.edu.al> ( **rubrika studentet** ); Rregullore e konkursit te pranimit. (Ref.nr. V.1.4.1.)

<sup>102</sup> Rregullore e konkursit te pranimit. (Ref.nr. V.1.4.1.)

<sup>103</sup> Faqja zyrtare UART <http://www.uart.edu.al> ( **rubrika Fakulteti I Muzikes** )

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UART ka një dokumentacion të detajuar ( rregullore e studimeve të ciklit dytë në nenet nga 17-deri 23) të aksesueshëm nga të gjithë në faqen zyrtare dhe ka ngritur një strukturë të plotë ( Sistemi PITAGORA, Sekretaria Mësimore, Sektori i Kurrikulës, Pedagogu mentor I programit ) lidhur me ndjekjen dhe informimin e studentëve gjatë studimeve në programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” <sup>104</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Konfirmohet nga dokumentacioni i shqyrtuar ( rregullorja e studimeve neni 24-28) dhe takimin me studentë, se UART ka një sistem informimi të studentëve si Sekretaria mësimore, dhe Zyra e kurrikulave lidhur me njohjen e kualifikimeve të mëparshme. Kishte një student I cili kishte kryer master profesional dhe vazhdonte këtë program për efekt punësimi dhe që kishte përfituar nga kjo praktikë ekuivalentimi dhe njohje të kualifikimeve të mëparshme që kishtë bërë. <sup>105</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	E përcaktuar në rregulloren e studimeve të këtij program studimi dhe nga takimi me stafin dhe studentet gjatë vizitës rezulton se studentët njihen që në ditën e pare të mësimin të lëndëve si me përmbajtjen ashtu edhe me kriteret e vlerësimit. Për ata ishte me shumë vlerë marrja në konsideratë në vlerësimin e tyre, përfshirja në veprimtari artistike së bashku me pedagogë. <sup>106</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Përveçse e përcaktuar në rregulloren e studimeve ( neni 30 deri 36 ) në planin mësimor është planifikuar një 2 orë në javë në auditor e udhëheqësit me studentin si mundësi edhe informimi ndihme dhe kontrolli të tyre lidhur me ecurine e përgatitjes së diplomës si pjesën që lidhet me performancën ashtu edhe me përgatitjen e mikrotezës. Nga takimi me studentë u konfirmua kjo procedurë që ndiqet nga fakulteti dhe departamenti. <sup>107</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të	Në faqen zyrtare të UART-së mund të konstatohet se janë të publikuara para fillimit të vitit akademik udhëzues që njohin kandidatët me programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” Nga takimi me studentë u konfirmua se që gjatë studimeve bachelor nepërmjet programit të karrierës ato kishin marrë informacion lidhur me

<sup>104</sup> Rregullores Mësimore e programit të studimit, Ciklit II.neni 17- 23 (Ref.nr.I.I.1.3.8.)

<sup>105</sup> Rregullores Mësimore e programit të studimit, Ciklit II.neni 24-28 (Ref.nr.I.I.1.3.8.)

<sup>106</sup> Syllabuset e planit mesimor. (Ref.nr.01.); Rregullores Mësimore e programit të studimit neni 13; 21; 23.

<sup>107</sup> Plani mesimor I programit moduli E . (Ref.nr.I.I.1.1.15.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q/Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	programin, qëllimet ,objektivat, përmbajtjen, kriteret e pranimit në këtë program. <sup>108</sup>		
<b>Konkluzione</b>	Arrin në konkluzionin se UART publikon në shërbim të studentëve tërë informacinë e nevojshëm për njohjen me të gjitha aspektet e regjistrimit vlerësimit dhe përfundimit të studimeve në këtë program studimi Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbyhet pjesërisht</b>	<b>Përmbyhet kryesisht</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Nepërmjet dokumentacionit të paraqitur nga GVB dhe takimi me studentë konfirmojmë se ata nepërmjet sekretarisë mësimore, dhe njërive të tjera ndihmëse, pedagogëve në paraqitjen e syllabuseve marrin një informacion të plotë dhe të vazhdueshëm lidhur me strukturën dhe organizimin e programit të studimit. Studentët shfrytëzojnë edhe Master classet dhe grupet në Whats AAp për tu shpërndarë informacionet që marrin lidhur me programin. <sup>109</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rezulton se UART ka përcaktuar në rregulloret e saj përgjegjësinë e tërë strukturave të saj për informimin e studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndëve, moduleve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” Në takimin me studentë u deklarua se ato merrnin informacion si nga pedagogët, sekretaria mësimore, si dhe nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UART-së. <sup>110</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me studentë u konfirmua se ata merrnin vazhdimisht informacion nga zyra e programit të karrierës për mundësitë e punësimit të tyre. Ata konfirmuan se kishte takime dy apo tre here në vit ku jo vetëm njiheshin me tregun e punës por edhe me mënyrën e konkurimit për vend pune. <sup>111</sup>

<sup>108</sup> Faqja zyrtare e UART <http://www.uart.edu.al>. **Rubrika studentet, pranimet**

<sup>109</sup> Plani mesimor I programit (Ref.nr.V.3.1.1.); Syllabysset Planit mesimor. (Ref.nr. V.3.1.2.)

<sup>110</sup> Rregullore Mësimore e UART neni **29; 78; 80.** (Ref.nr. I.I.1.3.7.);

<sup>111</sup> Regjistrimi në platformë GRADUA i studenteve. (Ref.nr. V.3.3.1.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga verifikimi I dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë vizitës konstatuam se UART, Njësia kryesore dhe Bazë, nepërmjet një sistemi menaxhimi eksistues efektiv ( Sekretari mësimore, zyra e kurrikulave, Grupet e lëndëve, Faqen zyrtare të institucionit ) vë në dispozicion të studentëve një informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me programin.</p> <p>Gjatë vizitës u konstatua se institucioni ka vënë në dispozicion të programit një infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e programit.<sup>112</sup></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga vizita në institucion konfirmohet se institucioni UART ka krijuar dhe ka në funksionim një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacioni duke filluar nga faja zyrtare, sekretaria mësimore, strukturat ndihmëse akademike, sistemi PITAGORA dhe aksesit në internet.<sup>113</sup></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ mendon se standarti realizohet plotësisht pasi institucioni ka një sistem efektiv menaxhimi të informacionit të përditësuar të aksesueshëm që lidhet me programin e studimeve</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b></p>	
<p>19 Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit në Sekretarinë mësimore, Zyrën e kurrikulave, sektorit të statistikës dhe informacionit pranë Drejtorise se Burimeve njerëzore dhe Informacionit Arkivë Protokoll, rezultojnë se UART ka statistika si për numrin e studentëve të regjistruar dhe për numrin e studentëve të diplomuar.<sup>114</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimit të tij gjatë vizitës në institucion pranë Sekretarisë mësimore në regjistrin themelitar, regjistrin të arritjeve dhe të sistemit PITAGORA rezultojnë se ka statistika për të gjitha aspektet që lidhen me vazhdimësinë e studimeve të këtij programi.</p>

<sup>112</sup> Faqja zyrtare UART <http://www.uart.edu.al>. rubrika Sekretaria mesimore; Studentet; Ambientet; Fakulteti i Muzikes.

<sup>113</sup> Fakulteti i Muzikes; Platforma Pitagora, ne faqen zyrtare. <http://www.uart.edu.al>

<sup>114</sup> Te dhena studentesh (Evidence pdf.)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në këto statistika jepet edhe numri i të larguarve, apo edhe të rregjistruar. Kështu në statistikën e vitit akademik 2019-2020 nga 9 studentë të rregjistruar 4 janë diplomuar, dhe 1 është rregjistruar, në vitin akademik 2020-2021 nga 12 studentë të rregjistruar 8 janë diplomuar dhe 3 studentë kanë ndërprerë studimet dhe në vitin 2021-2022 ka 7 studentë të rregjistruar dhe 1 student ka ndërprerë studimet. <sup>115</sup>			
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga vizita në institucion verifikohet se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga sistemi i brendshëm i administrimit të informacionit i digjitalizuar. Ky sistem është i aksesueshëm për të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe studentët në faqen zyrtare të UART-së. <sup>116</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimor, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Nga dokumentacioni që ka në dispozicion UART rezulton se ka të përcaktuar qartë në aktet dhe rregulloret e tij kontrollin periodik nga tërë njësitë që menajojnë programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”. Sektori mësimor ushtron kontrolle mbi njësitë përgjegjëse dhe merr feedback nga studentët lidhur me realizimin e programit, bën një analizë të gjendjes dhe harton një raport vjetor që i dërgohet Rektorit dhe më pas i dërgohet gjithë njësive bazë që mbulojnë programe studimi të nivelit të dytë. <sup>117</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Konfirmojme se njësia bazë që mbulon programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” harton raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, punësimin e tyre nepërmjet bashkëpunimit me Sektorin mësimor dhe programin e karrierës. U verifikua se nga të diplomuarit kishte 3 studentë të punësuar në arsimin parauniversitar dhe disa në Orkestrën e Forcave të Armatosura.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se institucioni administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit,			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<sup>115</sup> Regjister themeltar (Ref.nr.V.4.3.1.) ; Rregjister I arritjeve (Ref.nr.V.4.3.2.); Te dhena studentesh PDF

<sup>116</sup> Regjister themeltar (Ref.nr.V.4.3.1.) ; Rregjister I arritjeve (Ref.nr.V.4.3.2.); Te dhena studentesh PDF

<sup>117</sup> Rezultate te pyetsorit me studente Maj 2022. (Ref.nr.II.5.2.1.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konfirmojmë se UART ka përfshirë studentët nepërmjet përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si në Senatin akademik, Njësinë për Sigurimin e Cilësisë, Këshillit studentor si vetorganizim i studentëve, në GVB, si dhe merr feedback nga studentët edhe në përgatitjen e raportit vjetor lidhur me veprimtarinë e institucionit.</p> <p>Aktualisht janë 2 studentë antarë të Senatit, 1 student antarë i Këshillit të Etikës, 3 studentë në Komisionin e përhershëm të marrëdhënieve me studentë.<sup>118</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga takimi me studentë dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se ka një përfshirje reale të studentëve në vendimmarrje dhe që ka dhënë ndikimin e vet edhe në veprimtarinë e institucionit. Kështu në takimin me studentë u theksua se pyetori që realizohet për të dhënë opinionin mbi mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, ka ndikuar në përmirësimin e punës së pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi, pasi një vlerësim i dobët është shoqëruar në mos përzgjedhjen e pedagogut nga ana e studentëve për punën individuale.<sup>119</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të njësive kryesore dhe njësive bazë rezultojnë se gjatë tërë vitit akademik ushtrohen kontrole mbi ecurinë e procesit mësimor, dhe mbi bazën e tyre bëhet një analizë e plotë dhe nxirren konkluzione duke i pasqyruar ato në një raport vjetor në hartimin e të cilit janë të pranishëm edhe studentët. Ky raport dërgohej në Rektorat dhe më pas te të gjitha njësive të institucionit.<sup>120</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultateve, rishikimit dhe reflektimit</p>	<p>Ng shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se institucioni ka sanksionuar në statutin dhe rregulloret e miratuara barazinë dhe ndershmërinë në vlerësim, si dhe të drejtën e ankimimit, dhe të rishikimit të vlerësimit. Realizimi i vlerësimit në pjesën më të madhe të lëndëve artistike mbi bazën e performancës para publikut dhe përfshirja e studentëve në</p>

<sup>118</sup>Statutit të UART, Neni 126, (Ref.nr.II.1.2.1.); Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore në Fakultetin e Muzikes. Neni 56 (Ref.VSA.nr.36.7.12.2021); Rregulloren Mesimore të Ciklit II të Studimeve Master, Neni 41.( Ref.nr.II.1.3.8.)

<sup>119</sup>Model pyetësori të plotësuar. (Ref.nr.II.5.2.1)

<sup>120</sup> Rezultate të pyetësorit me studente Maj 2022. (Ref.nr.II.5.2.1.); Raport vjetor i Departamentit të Interpretimit.(Ref.nr.II.3.1.15.)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	koncerte dhe në Master Classet është një tregues i realizmit të këtyre elementëve të vlerësimit për studentë. <sup>121</sup>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se institucioni e përmbush plotësisht standartin pasi ka një përfshirje reale të studentëve në organet vendimmarrëse dhe merr në konsideratë të gjitha sugjerimet që vinë nga ata.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikuar në vizitën e realizuar në institucion rezulton se UART ka në funksionim njësi si, Sekretaria Mësimore, Zyra e kurrikulave, Drejtoria e Burimeve njerëzore informacionit dhe protokoll arkivës, Programit të Karrierës dhe Alumni, Sistemi PITAGORA etj., në shërbim dhe informim të studentëve. <sup>122</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Konfirmojmë se institucioni ka në funksionim një sistem të plotë me disa njësi si Sekretaria mesimore, Specialistes për informimin e studentëve, Zyra e këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Pedagogët përgjegjës për programin, që mundësojnë informimin këshillimin dhe aspekte të tjera që lidhen me ecurinë e procesit mësimor dhe vlerësimit. <sup>123</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga takimi me përfaqësuesen e Zyrës së Këshillimit dhe të Karrierës rezulton se kjo zyrë realizon një bashkëveprim të mirë me studentët duke u ofruar atyre informacion mbi procesin mësimor, probleme që lidhen me praktikën si artistike ashtu edhe mësimore, dhe në mënyrë të vecantë orientimin e tyre për tregun e punës, Në takimin me studentë u tha se kjo zyrë ka vazhdimisht kontakte me to dhe se dy ose tre herë në vit ka aktivitete të programuara në grup, për informimin apo orientimin e tyre për aspekte të ndryshme. <sup>124</sup>

<sup>121</sup>Foto nga koncerte, masterclasset. (Ref.nr. I.I.2.5.2.); Faqja zyrtare UART ([http://www.uart.edu.al/media/VSA\\_Nr.17\\_dt.07.10.2021,.PDF](http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.17_dt.07.10.2021,.PDF)).

<sup>122</sup> Faqja zyrtare UART. <http://www.uart.edu.al>

<sup>123</sup> Informacion zyrtar ne faqen web te universitetit (Ref.nr. I.I.2.2.3.)

<sup>124</sup> Rregullore studimi e programit neni 41 (Ref.nr. 01). Rregullore e NJSBC.(VSA nr.24. dt.07.10.2021);Vizita ne institucion ( takimi me studente)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.									
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Rezulton se Programi i Karrierës dhe Alumni ka një aktivitet efektiv me studentët e diplomuar në këtë njësi dhe si institucion. Platforma GRADUA është një instrument, i cili pas regjistrimit të studentit në platforme, është në gjendje të japë në menyrë sintetike e elektronike të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” Bashkëveprimi i studentëve të diplomuar me institucion bëhej më konkret nga fakti se studentët e punësuar ishin pjesë e institucioneve artistike me të cilat organizoheshin koncerte apo veprimtari të tjera artistike. <sup>125</sup>								
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se institucioni nëpërmjet njësive të ngritura realizon si informimim ashtu edhe orientimin e studentëve në aspekte të ndryshme të procesit mësimor dhe të punësimit.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga takimi gjatë vizitës me stafin akademik që mbulon programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” dhe drejtues të njësive, u konfirmua se për vetë kushtet specifike të procesit mësimor me studente të punës individuale me instrument, pedagogët ishin vazhdimisht në kërkim të metodave inovative në përputhje me nivelin dhe individualitetin e studentëve.

<sup>125</sup> Patforma GRADUA ne faqen web te UART. ( Rubrika Studentet Alumni ) ; Foto nga koncerte dhe masterclasseve. (Ref.nr. I.I.2.5.2.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	Rezulton se përfshirja në veprimtari artistike së bashku me studentë si dhe përfshirja e studentëve në Master Classe ishte një mundësi e mirë për të për përmisimin e metodave dhe punës mësimore me studentë. <sup>126</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga njësi kryesore si dhe vizita e bërë në institucion rezulton se Fakulteti i Muzikës në bashkëpunim me Departamentin e interpretimit dhe Grupin mësimor si përgjegjëse për këtë program studimi, ka në funksionim të vazhdueshëm mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor të programit. Si edhe u konfirmua gjatë takimit organizimi i pyetësorëve me studentë, analizat vjetore në njësinë baze ,njësinë kryesore dhe analiza vjetore në shkallë univeriteti janë tregues të një vlerësimi periodik. <sup>127</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Nepërmjet rregulloreve të institucionit është e garantuar përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe vlerësimit të studentëve.Përdorimi I pyetësorëve për vlerësimin e pedagogëve dy herë në vit para provimeve, përfshirja e një studenti në përgatitjen e raporteve të analizës vjetore , apo edhe në komisionin e vlerësimit të brendshëm janë evidente në këtë institucion. <sup>128</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Konstatohet që rezultatet e vlerësimit të brendshëm prezantohen dhe analizohen në Senatën Akademik të cilat behen publike ne faqen web ne rubriken vendime te S.A. Rezulton se se ka një rubrikë ku flitet për sigurimin e cilësisë në faqen zyrtare të institucionit ku deklarohet funksionimi i Komisionit të sigurimit të cilësisë dhe i NJSBC, <i>por nuk ka ndonjë publikim në faqen e internetit të institucionit për vlerësimin e brendshëm.</i> <sup>129</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Rezulton se institucioni nëpërmjet aktiviteteve kulturore artistike që organizon në bashkëpunim me institucione të ndryshme kulturore dhe artistike, promovon praktikave të mira që ka si për stafin akademik ashtu edhe për studentët pjesëmarrës, rezultuar nga mekanizmat vlerësues që institucioni përdor. <sup>130</sup>
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se institucioni UART ka një veprimtari konkrete për promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të praktikave të mira që ajo ka në fushën e përgatitjes së studentëve si artistë.

<sup>126</sup> Foto nga koncerte dhe masterclasseve. (Ref.nr. I.I.2.5.2.) Syllabusët e planit mësimor .( Ref.nr.01)

<sup>127</sup> Model pyetësori nga Sektori Mësimor të plotësuar. (Ref.nr. VI.1.2.1.); Analiza vjetore te DI, ( Ref.nr.I.I.3.1.15.)

<sup>128</sup> Model pyetësori nga Fakulteti 1 Muzikë (I plotësuar).(Ref.nr.VI.1.3.1.) Faqja web UART (**rubrika Transparenca,procedura informimi**)

<sup>129</sup> Faqja web e UART. Rubrika vendime senati **VSA.nr 16. Dt.09.02.2023**; Faqja web e UART (**Rubrika Transparenca,mekanizma monitorues, raporte performance**)

<sup>130</sup> Foto te koncerteve dhe masterclasseve (Ref.nr.I.I.2.5.2.)



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Konstatohet që sigurimi i brendshëm i cilësisë format dhe instrumentet e vlerësimit incohen nga Komisioni i sigurimit të cilësisë dhe Njësisë të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si institucione të pavarura ku përpunohen informacioni dhe marret feedback-u prej studentëve. Kjo njësi insiston në vlerësimin e dyanshëm, nga vetë stafi dhe nga studentët njekohësisht. Stafi është i detyruar të vetëvlerësojë punën çdo tre muaj.</p> <p>Konfirmohet që Zyra e sigurimit të cilësisë merr në konsideratë për vlerësimin e cilësisë së programit, rezultatet e studentëve, testimet, provimet, punët e pavaruara, pjesëmarrjen në auditor, mardhëniet e studentit me bibliotekën dhe literaturën, etj. Të gjitha këto struktura veprojnë bazuar në ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe Statutin e UART-së<sup>131</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se UART ka ngritur një sistem efektiv për sigurimin e cilësisë i cili vepron bazuar në legjislacionin dhe rregulloren e miratuar për veprimtarinë e saj si njësi. Rezulton se studentët kanë përfaqësimin e tyre në këtë njësi, por <i>nuk rezulton se ka një ekspert të jashtëm duke u justifikuar me faktin se shumica e specialistëve të fushës janë pjesë e veprimtarisë së institucionit dhe do të krijonte konflikt interesi.</i><sup>132</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UART përdor si vlerësimin e brendshëm ashtu edhe të jashtëm si dhe instrumente të tjerë për sigurimin e cilësisë. Konfirmohet se UART i është nënshtuar edhe vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional dhe me vendim të BA Nr 17. Date 24/03/2022 ka marrë vlerësim maksimal pozitiv .</p>

<sup>131</sup> Statuti i UART, neni 135 - 138. ( Ref.nr. I.I.1.2.1.); Plani strategjik 2018-2025.kreu 5.(ref.nr.I.I.1.3.3.);

Rregullore e funksionimit të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.( Vendimin Nt 24, date 07.10.2021 i SA)

<sup>132</sup> Rregullore e Funksionimit të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. ( Vendimin Nt 24, date 07.10.2021 i SA)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.							
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Konstatohet nga dokumentacioni i paraqitur se UART se analiza vjetore e veprimtarisë në shkallë njësie bazë, njësisë kryesore dhe si institucion në tërësi bazohet në tregues të qartë e të matshëm (si kontrollet e realizuara për mësimdhënien, pyetsorët me studentë, të dhënat nga analizat në grupet mësimore, të dhënat nga sekretaria mësimore për rezultatet e studentëve) për pasqyrimin e gjendjes aktuale si dhe rezultateve të arritura. Si edhe e kemi theksuar më parë një përvojë pozitive për të promovuar dhe nxitur këto arritje janë veprimtaria artistike e organizuar së bashku me studentë. <sup>133</sup>						
<b>Konkluzione</b>	GVJ lidhur me këtë standart mendon se përmbushet plotësisht pasi institucioni ka dhe zbaton si politika ashtu edhe procedura që realizojnë sigurimin e cilësisë nepermjet strukturave të ngritura dhe që funksionojnë. <i>Konstatohet se në përberjen e njësive të sigurimit të cilësive nuk ka një ekspert të jashtëm.</i>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe i verifikuar gjatë vizitës në institucion mund të konkludohet se institucioni përdor mekanizma të ndryshëm formalë për të realizuar mbikëqyrjen e programit të studimit Master i Arteve në "Violinë dhe Mësuesi" në shërbim të akreditimit. Cdo vit mësimor me urdhër të Rektoratit bëhet analiza vjetore, hartohet një raport analitik i cili miratohet në Senatin akademik dhe publikohet në faqën zyrtare të UART-së. Rezulton se me urdhër të ZV Rektorit se Departamenti i Interpretimit në bashkëpunim me komisionin e sigurimit të cilësisë realizon një raport analitik bazuar në pyetsorin e bërë me studentë, për procesin mësimor

<sup>133</sup> Model pyetësori të plotësuar nga studentë. (Ref.nr.II.2.5.1.) ; Analize vjetore e DI (Ref.nr.II.3.1.15.) Pyetsore të studentëve (Ref.nr. II.5.2.1.)

Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	dhe vlerësimin psiko-pedagogjik të tyre, që i dergohet atij dhe më pas të gjithë departamenteve të tjera për përmisimin e punës së tyre. <sup>134</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Rezulton se Departamenti I Interpretimit harton analizën vjetore të punës në këtë njësi duke përfshirë si arritjet në rezultatet e pritshme arritjet dhe praktikatat e mira ( organizim koncertesh me studentë p.sh.) si dhe mangësitë. Hartimi i raportit konstatohet se bëhet duke marrë në konsideratë disa tregues që vinë nga pyetsorët me studentë, vlerësimi I personelit,dhe mbështetja financiare. <sup>135</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinsticionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Konfirmojmë që UART aplikon metodologji vlerësimi të drejtëpërdrejta për të bërë vlerësimin lidhur me realizimin e programit të studimit. Instrumentat më të aplikuar janë monitorim i procesit mësimor, vlerësimi i studentëve gjatë vitit dhe në praktikatat profesionale, përfshirja e pedagogëve të jashtëm në diskutime, dhe të dhëna nga Alumni. <sup>136</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të	Konfirmojmë që UART aplikon metodologji vlerësimi të tërthortë për të bërë vlerësimin lidhur me realizimin e programit të studimit. Instrumentat më të aplikuar janë vetvlerësimi i stafit akademik të brëndëshëm dhe të jashtëm, ecurinë dhe rezultatet e të diplomuarve, dhe projektet e përbashkëta me aktorë të tjerë të institucioneve artistike. <sup>137</sup>

<sup>134</sup> Analize vjetore e veprimtarise se UART. Vendim SA nr 14. Dt.09.02.2023. **Faqja web UART.Senati vendime ;** Pyetsore te studenteve (Ref.nr. II.5.2.1.)

<sup>135</sup> Model analizë vjetore DI ( Ref.nr.I.I.3.1.15) ; Foto nga koncertet dhe masterclasseve (I.I.2.5.2.) ; Takim me stafin ne vizite ( minuta takimi ).


<sup>136</sup> Pyetsore te studenteve (Ref.nr. II.5.2.1.); Platforma GRADUA ne faqen web te UART ( **rubrika Alumni**);Formular vleresimi te praktikës profesionale.( derguar ne Ascal dt.12.01.2023 )

<sup>137</sup> Platforma Gradua ne kuader te Alumni. (**faqja web e UART rubrika Alumni**); Pyetsore te studenteve (Ref.nr. II.5.2.1.);

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se UART e ka ngritur në sistem monitorimin e realizimit të programit të studimit Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi, duke përdorur metoda dhe teknika si të drejtperdrejta ashtu edhe te terthorta.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UART në procesin e sigurimit të vilësisë rezulton se ka ndërtuar një sistem bashkëveprimi mes aktorëve të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm që marrin pjesë në këtë proces. Pjesëmarrja e studentëve në aplikimin e procesurave dhe komisioneve të vlerësimit të cilësisë, bashkëpunimi me studentët e diplomuar <b>nepërmjet programit GRADUA</b> , pjesëmarrja në projekte të përbashkëta me studentë aktuale etj. Por sic e kemi theksuar edhe me sipër nuk ka ndonjë ekspert të jashtëm të përfshirë në këtë proces. <sup>138</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rezulton se në Statutin e UART-së si dhe në rregulloren e NJSBC janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë e tërë aktorëve që marrin pjesë në procesin e vlerësimit të cilësisë në institucion. Këto detyra dhe përgjegjësi janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të UART-së. <sup>139</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet	Nga analiza e dokumentacionit dhe shqyrtimi i veprimtarive që organizon UART mund të konkludojmë se në procesin e sigurimit të cilësisë të

<sup>138</sup> Platforma Gradua ( **Rubrika Alumni ne faqen web.**);Statuti UART neni 136-137 (ref.nr.I.I.1.2.1.)

<sup>139</sup> Rregullore e NJSBC neni,5,6,7, ( VSA nr.24. dt.07.10.2021); Statuti UART neni 138 (ref.nr.I.I.1.2.1.)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	programit të studimit Master i Arteve në “ Violinë dhe Mësuesi” institucioni ngarkon me përgjegjësi njësinë kryesore dhe bazë si dhe shfrytëzon aktivitetet artistike për të përfshirë si stafin akademik , studentët dhe të diplomuarit në këtë proces. <sup>140</sup>								
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga dokumentacioni I shqyrtuar konstatohet se në procesin e përfshirjes dhe aktivizimit të stafit akademik dhe studentëve në procesin e vlerësimit respektimin e integritetit akademik ,të shmangies së diskriminimit e ka sanksionuar në aktet rregullatore dhe Kodin e Etikes së UART-së si dhe në rregulloren e funksionimit të Këshillit të Etikës, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. <sup>141</sup>								
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Konfirmohet se UART ka bërë pjesë aktive të procesit të vlerësimit të gjithë bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm nepërmjet aktiviteteve artistike që organizon si dhe të shfrytëzimit të Master Classeve për të marrë ekspertizë nga pedagogë të huaj pjesmarrës, studentë dhe bashkëpunëtorë. <sup>142</sup>								
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se ky standart përmbushet plotësisht pasi ka një sërri faktesh që flasin për një përfshirje aktive të strukturave përgjegjëse në procesin e vlerësimit, si dhe veprimtari artistike për të evidentuar këtë përfshirje.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të	Nga verifikimi në faqen zyrtare të UART-së rezulton se tërë aktiviteti i këtij institucioni që lidhet me sigurimin e brendshëm të cilësisë është

<sup>140</sup> Statuti I UART. Neni 136. Pika 1,2. (ref.I.I.1.2.1.); Foto nga veprimtarite ne UART. (Ref.nr.I.I.2.5.2.); Pyetsori me studente dhe staf. (ref.nr.II.5.2.1.)

<sup>141</sup> Urdher per ngritjen e grupit te punes per SBC. ( Ref.nr.II.5.2.7.); Faqe web e UART. **Keshilli i etikes ( kodi dhe rregullore e funksionimit te Keshillit te Etikes)**

<sup>142</sup> Veprimtari artistike dhe masterclasset. ( Ref.nr.I.I.2.5.2.); Shkembimet Erasmus foto. (Ref.nr. VI.4.5.2.)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	rregulluar në nenin 76 të Statutit të institucionit, është transparent dhe bëhet publik . <sup>143</sup>								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Konfirmojmë se UART publikon në mënyrë periodike në faqen zyrtare të tij analizën vjetore të punës mësimore dhe vlerësimin e programeve të studimit ( ku pasqyrohet edhe vlerësimi i programit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi”) duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, sipas legjislacionit në fuqi. <sup>144</sup>								
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se procesi i vlerësimit të programeve të studimit pas relacioneve të dhëna , shoqërohet me një plan masash me orientim përmisimin e mangësive kur janë të konstatuara.								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i rregulloreve që disponon UART dhe Fakulteti i Muzikës, dhe aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara nga kjo njësi, konstatojmë se është siguruar efektiviteti i këtyre veprimtarive për përmisimin dhe rritjen cilësore të performancës se studentëve në aspektin artistik dhe mësimdhënës. <sup>145</sup>								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga takimi me GVB të institucionit konstatojmë se janë organizuar një sërë veprimtarish për ndërgjegjësimin e stafit për vazhdimësinë e punës lidhur me vlerësimin periodik të programeve me synimin përmisimin e vazhdueshëm të tyre. Takime, ekspertizë, vlerësime dhe analiza rezulton se janë organizuar periodikisht në këtë institucion.								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ</i> mendon se standarti përmbushet plotësisht pasi institucioni ka një sistem transparent dhe efektiv sipas legjislacionit në fuqi për sigurimin e brendshëm të cilësisë								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

<sup>143</sup> Statuti i UART. Neni 76. (Ref.nr. I.I.1.2.1.); Faqe web.UART. ( Rubrika transparenca vendime )

<sup>144</sup> Faqe web.UART ( Rubrika transparenca vendime )

<sup>145</sup> Pjesmarrje e studenteve ne veprimtari te perbashketa me pedagogje ( Foto 60 vjetorit UART)

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Univeriteti i Arteve Tiranë ”

### **Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit Master i Arteve në “ Violinë dhe Mësuesi “ është i vetmi program studimi në Violinë i cili ofrohet dhe realizohet nga UART si një institucion unik në Arsimin e Lartë në vendin tonë me një eksperiencë shumvjeçare në formimin universitar në fushën e kërkimit artistik shkencor por edhe në mësuesi, hartuar duke u bazuar në eksperiencën e fakulteteve homologe europiane.
2. Programi (struktura e lëndëve, sipas kategorive) është adekuat, me mundësi për studim të thelluar në interpretim në instrument, në repertor të gjerë, të larmishëm dhe adekuat për nivelin. Përfshirja e lëndëve që e forcojnë komponentët e mësimdhënies bashkë me praktikën i kontribuon mjaftueshëm përgaditjes pedagogjike e didaktiko-metodike për profesionin e mësuesisë në shkollat e përgjithshme dhe ato profesionale të muzikës.
3. Stafi akademik që mbulon programin e studimit Master i Arteve në “Violinë dhe Mësuesi” me tituj dhe grada shkencore, ka një karrierë artistike shumë të njohur në vendin tonë dhe jashtë, më një bashkëpunim me artistë të huaj, si në veprimtari artistike ashtu edhe mësimdhënëse. Bashkëpunimi me institucionet profesionale muzikore në vend (TOB, orkestrat profesionale, etj) dhe mundësia e punësimit të menjëhershëm të studentëve të këtij programi në orkestrat profesionale të vendit është po ashtu një vlerë e shtuar.
4. Programi i studimit Master i Arteve në “ Violinë dhe Mësuesi “ realizon objektivat e tij në formimin artistik dhe mësimdhënës, bazuar në një bashkëpunim dhe përfshirje të studentëve në veprimtari artistike që organizon si koncerte apo evente artistike. Ky program ka në masën mbi 80% të studentëve të diplomuar të punësuar si një tregues i rezultateve të mira në fushën e përgaditjes artistike dhe mësimdhënëse, dhe si garanci për vazhdimësi për të ardhmen.
5. Programi i studimit Master i Arteve në "Violinë dhe Mësues" ka një infrastrukturë moderne për formimin artistik dhe një bibliotekë funksionale në shërbim të stafit dhe studentëve në dispozicion për të përmbushur rezultatet e pritshme. Infrastruktura, hapësirat e nevojshme dhe adekuate, për studim individual, në ansamble dhe në orkestër janë të bollshme dhe mirë të organizuara.
6. Programi i studimit Master i Arteve në “ Violinë dhe Mësuesi “ përfshin studentët e diplomuar nepërmjet ALUMNI-t në përmisimin e objektivave dhe përmbajtjes të programit, duke shfrytëzuar përfshirjen e tyre në veprimtari artistike, dhe ekspertizën që ata ofrojnë.


### **Pika të dobta**

1. Përditësimi i literaturës dhe metodologjisë, sidomos në modul A në disa syllabuse nuk dokumentohet. Ka syllabuse me jo të njëjtin format, pa kodifikim, dhe pa vlerësim të detajuar. (Standarti II.1. kriteri 8; standarti II.3. kriteri 4; standarti III.3. kriteri 3 ). Nuk ka dokumentim të procesit të përditësimit të programit të studimit, diskutimi me aktorët e jashtëm, si institucionet

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



profesionale muzikore etj nuk bëhet në mënyrë formale dhe nuk evidentohet formalisht.( **standarti II.5 kriteri 1**)

2. Në procesin e vlerësimit të studentëve për lëndët teorike mungon vlerësimi elektronik i përdorur gjatë pandemisë Covid -19 ( **standarti III.3. kriteri 3**) si dhe nuk dokumentohet kontrolli i plagjiaturës nëpërmjet platformës elektronike që disponon cdo institucion (**standarti III.3. kriteri 4** ).
3. Ndonëse bëhen nuk publikohen raportet e Njesisë të Sigurimit të brëndeshëm të cilësisë (**standarti VI. 1. Kriteri 4**) dhe nuk ka ekspert të jashtëm në këtë njësi (**standarti VI.2. kriteri 2** )

### **Rekomandime**

1. GVJ sugjeron që struktura e programit me module më të plota, me më me shumë kredi, mund të lehtësojë administrimin dhe procedurat. Vetë integrimi i masterëve për instrumentet individual në një program të vecantë Master i Arteve në Instrumentet harkore-(instrumenti përkatës) dhe mësuesi do të lehtësonte procesin e administrimit meqë të gjitha programet e studimit i kanë të gjitha lëndët e tjera të njëjta, përpos që dallon instrumenti kryesor dhe metodika e instrumentit përkatës.
2. Të shikohet mundësia e futjes në planin mësimor të lëndës së Metodike e Kërkimit Shkencor, që i ndihmon studentët për përgatitjen e mikrotezës në provimin teorik të diplomës dhe për të bërë punë shkencore në të ardhmen.
3. Të bëhet dokumentimi i procesit të përditësimit të programit të studimit nëpërmjet përfshirjes dhe marrje ekspertize të aktorëve të brëndshëm dhe të jashtëm si institucionet profesionale muzikore të interesuar për këtë program, si dhe unifikimi sipas formatit të kërkuar kodifikimi dhe përditësimi të literaturës tek disa syllabuse.
4. Në vlerësimin e studentëve për lëndët teorike ku bëhet provim me shkrim, të aplikohet sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimit, sistem që sipas deklarimit të studentëve ishte përdorur gjatë pandemisë me platformat Moodle dhe Teams.

### **Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Arts on "Violin and Teaching" provided by the Higher Education Institution "UART"**

#### **Strengths and affirmations**

1. The study program Master of Arts in "Violin and Teaching" is the only study program in Violin which is offered and realized by UART as a unique institution in higher Education in our country with many years of experience in university education in the field of artistic and scientific research but also in teaching, designed based on the experience of the European counterpart faculties.
2. The program (structure of subjects, according to categories) is adequate, with opportunities for in-depth study in interpretation on the instrument, in a wide, varied repertoire and adequate for the level. The inclusion of subjects that strengthen the teaching components together with practice contributes

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



sufficiently to the pedagogical and didactic-methodical preparation for the profession of teaching in high schools and professional music.

3. The academic staff covering the study program Master of Arts in "Violin and Teaching" with scientific titles and Phd, has a very well-known artistic career in our country and abroad, with a collaboration and teaching and artistic activity with foreign artists. Cooperation with professional musical institutions in the country (TOB, professional orchestras, etc.) and the possibility of immediate employment of the students of this program in the professional orchestras of the country is also an added value.
4. The study program Master of Arts in "Violin and Teaching" realizes its objectives in artistic and teaching training, based on a collaboration and involvement of students in the artistic activity that it organizes, such as concerts or artistic events. This program has more than 80/% of graduate students employed as an indicative of good results in the field of artistic and teaching training, and as a guarantee of continuity for the future.
5. The study program Master of Arts in "Violin and Teaching" has a modern infrastructure for artistic training and a functional library at the service of staff and students available to fulfill the expected results. The infrastructure, the necessary and adequate spaces for individual study, in ensembles and in the orchestra are abundant and well organized.
6. The study program Master of Arts in "Violin and Teaching" includes graduate students through ALUMNI in improving the objectives and content of the program, utilizing their involvement in artistic activity, and the expertise they offer.

#### Weaknesses

1. The updating of literature and methodology, especially in module A in some syllabuses is not documented. There are syllabuses with different formats, without codification, and without detailed assessment. **(Standard II.1. Criterion 8; Standard II.3 Criterion 4; Standard III.3. Criterion 3)**. There is no documentation of the process of updating the study program, the discussion with external actors, such as professional music institutions, etc. is not done in formal way and is not formally evidenced **(standard II.5 criterion 1)**
2. 3. In the students evaluation process for theoretical subjects, the electronic evaluation used during the Covid-19 pandemic **(standard III.3. criterion 3)** is missing, as well as the control of plagiarism is not documented through the electronic platform that each institution has **(standard III.3. criterion 4)**.
3. Although they are made, the reports of the Internal Quality Assurance Unit are not published **(standard VI. 1. Criterion 4)** and there is no external expert in this unit **(standard VI.2. criterion 2)**


#### Recommendation

1. The structure of the program with more complete modules, with more credits, can facilitate administration and procedures. The very integration of masters for individual instruments into a separate program Master of Arts in Bowed Instruments (relevant instrument) and teacher would

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



facilitate the administration process since all study programs have all other subjects the same, except that it differs the main instrument and the methodology of the corresponding instrument.

2. To see the possibility of including the subject of Scientific Research Methodology in the curriculum, which helps students to prepare the microthesis for the final theoretical exam and to do scientific work in the future.
3. To be documented the process of updating the study program through the inclusion and obtaining expertise of internal and external actors such as the professional music institutions interested in this program, as well as the unification according to the required format, codification and updating of the literature in some syllabuses.
4. In the assessment of students for theoretical subjects where there is a written exam, the electronic testing and evaluation system should be applied, a system that according to the students' statement was used during the pandemic with the Moodle and Teams platforms.

---

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



- Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen kryesisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen jo
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE LIBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al